

ANALIZA E KUADRIT POLITIK DHE LIGJOR LIDHUR ME TË DREJTAT SOCIAL EKONOMIKE TË TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË



“Analiza e kuadrit ligjor, politikave dhe praktikave mbi të drejtat e të huajve në Republikën e Shqipërisë ” u realizua nga Qendra ALTRI në kuadër të nismës “*Inclusion of FOreigners in WB – accesS to social and Economic Rights (FOSTER)*” në zbatim nga Komiteti Shqiptarë i Helsinkit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Qendrës A.L.T.R.I dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e donatorit apo të Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë e mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet Web apo sisteme të tjera pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

Qendra ALTRI

Email: gendra.altri@gmail.com

Tiranë, 2024

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtime	2
I. Hyrje	3
II. Përmbledhje ekzekutive	4
III. Kuadri politik dhe ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar për të huajt	5
3.1 Kuadri politik për të huajt në Shqipëri.....	5
3.2 Kuadri ligjor mbi të drejtat e të huajve në Shqipëri;.....	8
3.3 Standardet ndërkombëtare dhe evropiane	15
3.3.1 Standardet ndërkombëtare sipas Kombeve të Bashkuara.....	15
3.3.2. Standardet ndërkombëtare sipas të drejtës Evropiane	19
IV. Procedurat për përfitimin e vizës dhe lejes së qëndrimit për të huajt	22
4.1. Procedura për pajisjen me vizë	22
4.2 Procedurat për marrjen e lejes së qëndrimit dhe llojet e lejeve.	25
V. Procedurat për të përfituar mbrojtjen ndërkombëtare dhe statusin e refugjatit	28
5.1 Procedura për Shqyrtimin e Kërkesës për Mbrojtje Ndërkombëtare (Azil) dhe Statusi i Refugjatit.....	29
5.1.2 Persona që i përkasin kategorisë së veçantë dhe fëmijët e pashoqëruar.....	35
VI. Qasja e të huajve në Shërbime publike	37
6.1 Arsimitimi dhe Shërbimet Sociale: Qasja e të huajve në arsim dhe shërbime shëndetësore.....	37
6.1.1 Aksesimi i të huajve në sistemin arsimor.	37
6.1.2 Qasja e refugjatëve në arsim si një kategori veçantë e të huajve.	39
6.1.3 Qasja në shërbimet shëndetësore	44
6.2 Punësimi i të Huajve: Rregullat dhe kërkesat për punësimin e të huajve.....	45
VII. Konkluzione dhe Rekomandim	49
7.1 Konkluzione dhe gjetjet kryesore.	49
7.2 Rekomandimet e Analizës:	49

Shkurtime

BE	Bashkimi Evropian
CRC	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
DPSHR	Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme
EASO	Zyra Mbështetëse Evropiane për Azilin
ICCPR	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
ICESCR	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
ICRMW	Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjes së Tyre
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrimin
MB	Ministria e Brendshme
OJF	Organizatë jo fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë
QKPA	Qendra Kombëtare e Pritjes së Azilkërkuesve
REKH	Regjistrit Elektronik Kombëtar për të Huajt
RMSA	Organizata Shërbime për Refugjatët dhe Migrantët në Shqipëri
RSH	Republika e Shqipërisë
SKM	Strategjia Kombëtare për Migracionin
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. Hyrje

Duke mbajtur në konsideratë rritjen e numrit të të huajve që hynë në Republikën e Shqipërisë ku përfshihen të huajt që vijnë për arsye qëndrimi, kalimi transit, punësimi, studimi dhe refugjatët nga vendet e treta vlerësojmë se respektimi i të drejtave të të huajve ka marrë një rëndësi të veçantë dhe ka sjellë nevojën për një vëmendje me të madhe të politikave për këtë kategori. Hartimi dhe zbatimi i këtyre politikave lidhet sa me detyrimet kushtetuese aq edhe me detyrimet e Shqipërisë në kuadër të anëtarësimit në BE dhe lëvizjes së lirë të punonjësve sipas kapitullit 24.

Sipas *screening report* për vitin 2023 evidentohet se *‘në fushën e migracionit të ligjshëm janë të nevojshme ndryshime, veçanërisht për të përafëruar disa dispozita mbi bashkimin familjar, me lejen e vetme (single permit) dhe me ndryshimet e fundit në kartën blu të BE-së. Gjithashtu edhe përsa i përket migracionit të paligjshëm Shqipëria duhet të kryejë përmirësimet e nevojshme veçanërisht në lidhje me kthimin e migrantëve të paligjshëm në vendin e origjinës’*.¹ Për të huajt në pozita të cënueshme në raport evidentohet se Shqipëria nuk ka ambjente të veçanta për mbajtjen e të miturve të pashoqëruar, grave në rrezik dhe personave me kushte të rënda mjekësore.

Sipas të dhënave të INSTAT numri i të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri rezultoi 18.151 banorë nga të cilët të huajt rezidentë me origjinë nga Italia, Kosova dhe Turqia përbëjnë numrin më madh. Ndërkohë për sa u përket azilkërkuesve rezultoi se kanë si vende origjine Afganistanin, Ukrainën, Sirinë, Egjiptin dhe Tunizinë. Gjithashtu, vitet e fundit Shqipëria ka shërbyer si vend tranzit për refugjatët që shkojnë drejt Bashkimit Evropian. Të drejtat e të huajve dhe refugjatëve marrin rëndësi të veçantë në situatën aktuale kur shtetet e BE-së për përballimin e flukseve të migrantëve kanë ndërmarrë masa të jashtëzakonshme siç është shembulli i protokollit mes Shqipërisë dhe Italisë.

Në këto kushte kjo analizë synon të sjellë një panoramë të kuadrit politik dhe ligjor në Republikën e Shqipërisë në raport me të drejtën ndërkombëtare, legjislationin e Bashkimit Evropian dhe përvojat e vendeve të tjera sa i përket të drejtave të të huajve. Kjo analizë ka si qëllim të krijojë një panoramë të qartë në lidhje me të drejtat social ekonomike të të huajve në vendin tonë dhe të rekomandojë përmirësimet e nevojshme të konstatuara.

¹ Screening report Albania 2023 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf faqe 88-93

II. Përmbledhje ekzekutive

Analiza mbi të drejtat e të huajve në Shqipëri vlerëson mekanizmat ligjorë dhe politikë që synojnë të mbështesin integrimin dhe mbrojtjen e të huajve, përfshirë grupet vulnerabël si refugjatët dhe azilkërkuesit. Sipas legjislacionit shqiptar, "i huaj"² përfshin çdo individ që nuk është shtetas shqiptar, duke përfshirë edhe ata që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, si emigrantë, migrantë dhe refugjatë. Duke qenë vend kandidat për anëtarësim në BE, Shqipëria ka harmonizuar një pjesë të konsiderueshme të legjislacionit të saj me atë të BE-së, përfshirë Direktiva të ndryshme. Gjithashtu, marrëveshjet dypalëshe dhe rajonale me organizata si Frontex kanë ndihmuar në menaxhimin e flukseve migratore dhe frenimin e migracionit të parregullt.

Nga ana tjetër "refugjat"³ është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1 (A) të Konventës së Gjenevës. Në këtë kontekst, analizohen mekanizmat ligjorë dhe politikë që mbështesin integrimin dhe mbrojtjen e të huajve dhe refugjatëve, përfshirë grupet vulnerabël, duke shqyrtuar efektivitetin e zbatimit të tyre në praktikë. Shqipëria është pjesë e sistemit ndërkombëtar të mbrojtjes së refugjatëve dhe ofron politika të qarta për azilkërkuesit në përputhje me Konventën e Gjenevës, garantuar një proces të drejtë dhe të sigurt për ata që kërkojnë mbrojtje.

Megjithatë, sfidat mbeten. Shqipëria përballlet me mungesë kapacitetesh për akomodimin e azilkërkuesve dhe integrimin e migrantëve në tregun e punës dhe shoqëri. Një tjetër sfidë thelbësore është qasja e kufizuar në procedurat e azilit dhe trajtimi i të miturve të pashoqëruar. Po ashtu, pavarësisht se kemi patur progres në harmonizimin e dispozitave ligjore, sfidat mbeten edhe në nevojën për rishikim dhe harmonizim të vazhdueshëm të këtyre akteve, sipas rastit kur ndodhin rishikime në nivel Evropian. Rasti konkret është përafrimi i Ligjit për të huajt, i cili është një ligj i ri, i harmonizuar më herët me Kartë Blu të Bashkimit Evropian, por si shkak i ndryshimeve të ndodhura në këtë Kartë nga BE, është e nevojshme të bëhen ndryshimet e nevojshme edhe në Ligjin tonë për të huajt.

Analiza vlerëson të drejtat sociale dhe ekonomike të të huajve në Shqipëri dhe sugjeron përmirësime të nevojshme, kur është e mundur, me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor/rregullator apo përmirësimin të qasjes në shërbime të kësaj kategorie. Për efekt trajtimi në këtë analizë, trajtimi sa i përket refugjatëve, të cilët janë një kategori e të huajve, është bërë në mënyrë të ndarë duke qenë se kanë rregullim dhe procedura të veçanta për trajtimin e tyre.

² Neni 3 pika 9 i ligjit Nr. 79 datë 18.10.2021 "Për të huajt";

<https://qbz.gov.al/share/h6NNRj6cQMey7WFNnu7wng>

³ Neni 3 pika 28 i ligjit Nr. 10 datë 24.02.2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".

III. Kuadri politik dhe ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar për të huajt

Në fokus të këtij kreu është identifikimi dhe analizimi i kuadrit të plotë ligjor dhe politik në Shqipëri për të drejtat dhe shërbimet që ofrohen për të huajt në Republikën e Shqipërisë. Në këtë Kre do të trajtohen aktet kryesore që parashikojnë rregullimin e të drejtave të të huajve duke mundësuar një panoramë të përgjithshme të secilit akt, për tu ndalur më tej në kapitujt pasardhës në procedura dhe shërbime konkrete për këtë kategori. Gjithashtu, një fokus i veçantë do t'i kushtohet standardeve ndërkombëtare për të mundësuar një analizë më të thelluar në kuadër të rregullimit dhe garantimit të të drejtave të të huaje në vendin tonë sipas këtyre standardeve.

3.1 Kuadri politik për të huajt në Shqipëri

Kuadri politik për të huajt në Shqipëri synon të sigurojë një menaxhim efektiv të flukseve migratore, duke respektuar të drejtat e të huajve dhe duke përmbushur detyrimet ndërkombëtare të vendit. Sa i përket kuadrit politik hartimi i politikave për menaxhimin e migracionit është mbështetur nga disa strategji kombëtare dhe dokumente strategjike. Disa prej tyre përfshijnë:

- Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030⁴
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030;
- Plani Kombëtar për Integrim Evropian 2022–2024;
- Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027;
- Strategjia Kombëtare për Diasporën dhe Plani i Veprimit 2021–2025;
- Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025;
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030;
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe Plani i Veprimit;

Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030 (SKM) në Shqipëri synon një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit, duke përfshirë të huajt. Objektivat kryesore përfshijnë qeverisjen efektive të migracionit, zhvillimin e politikave për migracionin për arsye punësimi, dhe promovimin e migracionit të rregullt. Gjithashtu, strategjia fokusohet në mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare, duke kontribuar në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Kjo Strategji dhe Plani i Veprimit 2024–2030 trajtojnë disa pika kyçe, të ngritura në raportin e fundit të Komisionit në fushën e migracionit. Së pari, i përgjigjet nevojës për kuadrin ligjor dhe institucional për të mundësuar mekanizma efektivë për menaxhimin dhe koordinimin e migracionit. Së dyti, institucionet shqiptare janë të angazhuara për bashkëpunim ndërkombëtar për të “lehtësuar kthimin dhe ripranimin e sigurt dhe dinjitoz”, një aspekt kyç i qeverisjes së migracionit, i monitoruar vazhdimisht nga BE-ja. Ky angazhim është i lidhur ngushtë me synimin afatgjatë

⁴ VKM-ja nr. 271, datë 2.05.2024, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024–2026”. https://qbz.gov.al/share/05q_2DCYQFaOvFDBBf8JNw

për parandalimin e plotë të fenomenit të migrimit të parregullt të shtetasve shqiptarë, nëpërmjet ofrimit të informacionit, mbrojtjes dhe ndihmës në të gjitha fazat emigrimit.⁵

Qëllimet politike të prezantuara dhe që synohen të arrihen nëpërmjet Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 janë si më poshtë:

- *Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri; Objektivi i politikës për garantimin e qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri ka qenë në thelb të SKM-së dhe PV-së 2019–2022, duke shërbyer si një bazë mbi të cilën mund të bëhet përparim në shtyllat e tjera tematike. Rëndësia thelbësore e përafrimit të kuadrit ligjor me atë të BE-së dhe me kornizat e tjera ndërkombëtare, si dhe e përmirësimit të koordinimit të aktiviteteve të qeverisjes së migracionit, është ripërsëritur pasi progresi drejt këtij objektivi është objekt monitorimi të vazhdueshëm për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.*⁶
- *Zhvillimi i politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin social-ekonomik kombëtar/vendor; Strategjia aktuale zgjeron masat parandaluese, duke ofruar stimuj për migracion të rregullt dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, me fokus në përfitimet ekonomike, arsimore dhe sociale. Ajo thekson nevojën për angazhimin e autoriteteve vendore, shërbimeve konsullore dhe aktorëve privatë për një qasje gjithëpërfshirëse. Kjo qasje synon të parandalojë migrimin e parregullt dhe të kontribuojë në zhvillimin e Shqipërisë.*⁷
- *Promovimi i migracionit të rregullt, mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare; Strategjia e re për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve fokusohet në ofrimin e shërbimeve të dedikuara për integrimin e tyre. Ajo përfshin programe të përshtatura për nevojat e migrantëve si një kategori e cenueshme, duke marrë parasysh moshën dhe gjininë. Përfshirja e migrantëve në shërbimet bazë dhe angazhimi për zgjidhje afatgjata janë thelbësore, duke adresuar gjithashtu sfidat e mbledhjes së të dhënave dhe investimeve në infrastrukturë. Strategjia synon të forcojë kushtet për shtetësi dhe qëndrueshmëri, duke nxitur pjesëmarrjen e migrantëve në zhvillimin lokal.*⁸
- *Forcimi i sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, garantimi i të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme. Strategjia aktuale synon forcimin e sistemit të azilit duke përmirësuar procedurat, rritjen e kapaciteteve dhe garantimin e të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve, në përputhje me standardet e BE-së dhe Paktin Global për Refugjatët. Ajo përfshin përafrimin e kuadrit ligjor me atë ndërkombëtar, rritjen e efikasitetit në trajtimin e kërkesave për azil dhe mbrojtjen e personave me nevoja të veçanta, veçanërisht fëmijët e pashoqëruar. Përmirësimi i infrastrukturës në qendrat pritëse dhe integrimi social-ekonomik i refugjatëve përmes programeve të dedikuara janë gjithashtu prioritete kryesore.*⁹

⁵ Shih po aty

⁶ Po aty, fq 28.

⁷ Po aty, fq 29.

⁸ Po aty, fq 30.

⁹ Po aty, fq 30.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030¹⁰- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) deri në vitin 2030 konsideron migracionin si një faktor të rëndësishëm për zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë, duke qenë thelbësore për procesin e integritimit në BE. Dokumenti synon të adresojë sfidat e migracionit në vend, duke përmirësuar mekanizmat e riintegritimit për migrantët e kthyer dhe duke forcuar politikat për menaxhimin e migracionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ai gjithashtu synon një qeverisje të mirë të lëvizjeve migratore për të rritur ndikimin e tyre pozitiv në zhvillimin kombëtar dhe lokal.

SKZHIE-ja fokusohet në promovimin e migracionit të rregullt, mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe integrimin e tyre të qëndrueshëm në shoqërinë shqiptare. Një tjetër qëllim kryesor është nxitja e investimeve njerëzore dhe kapitale të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit, duke synuar që politikat për migracionin të kontribuojnë në rritjen social-ekonomike të vendit.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024 identifikon mangësitë dhe masat prioritare për përafrimin e legjislacionit dhe standardeve kombëtare me ato të BE-së në të 33 kapitujt e acquis-it të BE-së. PKIE-ja ofron një vlerësim të detajuar të situatës, dhe mangësive dhe identifikon fushat prioritare relevante si qeverisja e migracionit të rregullt dhe të parregullt, azili, politika e vizave (kapitulli 24), aksesin e barabartë dhe jodiskriminues në tregun e punës dhe koordinimi i sistemit të sigurimeve shoqërore (kapitulli 2), njohja reciproke e kualifikimeve profesionale (kapitulli 3), statistikat demografike, sociale dhe ekonomike (kapitulli 18), standardet minimale dhe mosdiskriminimi në punë, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe bashkëpunimin, në lidhje me punësimin, punën dhe çështjet sociale (kapitulli 19).¹¹

Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 – ndër synimet kryesore të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit është lehtësimi i migracionit të organizuar, të sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm, nëpërmjet zbatimit të politikave të migracionit të planifikuara dhe të menaxhuara mirë, së bashku me parandalimin e migrimit të parregullt dhe menaxhimin e fluksit migrator.¹²

Strategjia Kombëtare për Diasporën vlerëson potencialin e imigrantëve jo vetëm sa i takon remitancave, por dhe rolin për zhvillimin e vendit përmes njohurive dhe vlerave të fituara në shtetet e tjera. Nga ana tjetër, programi shtetëror për mbështetjen dhe përfshirjen e diasporës shqiptare ka si qëllim të forcojë politikat dhe strukturat institucionale për ta parë migracionin si një mundësi për zhvillimin e vendit. Përfitimet neto të kapitalit njerëzor (kontributi në aftësi

¹⁰ VKM-ja nr. 88, datë 22.2.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Evropian 2022–2030” <https://qbz.gov.al/share/3VxOqmLUSwOWhi00jsdZUg> ;

¹¹ Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024; https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/NPEI_2022-2024_EN-.pdf

¹² VKM-ja nr. 1117, datë 16.12.2020, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe Planit të Veprimit 2021–2023” https://qbz.gov.al/share/E_qMh2nrQ6SGDzoFUWX2qg

i imigrantëve) dhe integrimi i suksesshëm i emigrantëve të kthyer, janë ndër objektivat kryesorë të këtij dokumenti politik.¹³

Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025 - Një pjesë e çështjeve të migracionit trajtohen edhe në Strategjinë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda nga këndvështrimi i luftës kundër kalimit të paligjshëm të kufirit nga emigrantët, i njohur ndryshe si kontrabandimi i migrantëve.¹⁴

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030¹⁵ ofron një vlerësim të situatës së migracionit nga këndvështrimi i punësimit dhe aftësive, duke theksuar se plakja e popullsisë dhe lëvizjet migratore kanë zvogëluar rritjen e fuqisë punëtore në vend. SKPA-ja, në masat që synojnë të realizojnë vizionin e saj për punësim dhe aftësi për të gjithë, gjatë të gjithë jetës, në mënyrë specifike për lëvizshmërinë e fuqisë punëtore, parashikon ndërhyrje që synojnë lidhjen me platformën evropiane të zyrave të punësimit (EURES), përmirësimin e kuadrit rregullator për rekrutimin e drejtë të punonjësve, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet zyrave publike dhe private të punësimit, identifikimin e aftësive të munguara në vend e rajon dhe plotësimin e tyre nëpërmjet promovimit të lëvizshmërisë në rajonin e Evropës Juglindore.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 - specifikisht parashikohen ndërhyrje për: përmbushjen e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë migrante; rritjen e aksesit të grave migrante në shërbime dhe produkte financiare, informimin e grave migrante për të drejtat pronësore; reduktimin e barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritjen e aksesit të grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet (migrantë dhe azilkërkues etj.), për punë të denjë edhe në sektorët e punësimit jotradicional (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë) dhe përmirësimin e shërbimeve të specializuara mbështetëse për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, trafikimit dhe shfrytëzimit seksual, nga të gjitha grupet e grave (përfshirë gratë migrante).¹⁶

3.2 Kuadri ligjor mbi të drejtat e të huajve në Shqipëri;

Legjislacioni shqiptar ka një kuadër të plotë të rregullimi dhe garantimit të të drejtave të të huajve duke nisur me parashikimet që në ligjet themelore, të tilla si **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë**, i cili rregullon marrëdhëniet e punonjësve vendas dhe të huaj, dhe zbatohet njëjloj si për shtetasit shqiptarë ashtu edhe për të huajt, si dhe ligje të tjera kryesore, si: ligji nr. 79/2021; “Për të huajt”; ligji nr. 10/2020, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve

¹³ VKM nr. 585 datë 22.07.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe të planit të veprimit 2021–2025”, fq 9 <https://qbz.gov.al/share/VHkJINldSZ6BDpy9DkjViA>

¹⁴ VKM nr. 1140, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe planin e veprimit 2021–2022” fq. 10 <https://qbz.gov.al/share/q566V-vyTwyGMvh4GFbTsg>

¹⁵ VKM-ja nr. 173, datë 24.3.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, Planit të Veprimit për zbatimin e saj, si dhe Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023–2024” <https://qbz.gov.al/share/7-qucOW0Q6alGY0Hx10Hew>

¹⁶ VKM nr. 400, datë 30.06.2021, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe të planit të saj të veprimit” fq 31 <https://qbz.gov.al/share/tktXmfIRC2k4gkz9V4COg>

shqiptarë për qëllime punësimi”; ligji nr. 10221/2020, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, etj. Ndërkohë që legjislativi dytësor është kuadri rregullator që buron nga këto akte ligjore, kryesisht vendime të Këshillit të Ministrave dhe urdhra apo udhëzime specifike që rregullojnë dhe lehtësojnë procedurat e qëndrimit të ligjshëm për të gjithë të huajt që dëshirojnë të jetojnë apo punojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.¹⁷

Legjislativi kombëtar për migracionin, në përgjithësi, pasqyron parimet e konventave ndërkombëtare për të drejtat e migrantëve. Zbatimi i këtyre të drejtave realizohet nëpërmjet disa parimeve të përgjithshme si: respektimi i të drejtave të njeriut, mosdiskriminimi, mosnënshtrimi ndaj torturës, trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues, parimi i integritetit dhe dinjitetit, bashkimit familjar, garantimit të kujdesit shëndetësor, arsimimi, integrimi social, etj.¹⁸

➡ **Ligji “Për të huajt”** është ligji i ri specifik i cili ka për qëllim rregullimin e regjimit të hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë.¹⁹ Ky akt është në përputhje me 18 akte të acquis të BE-së dhe garanton se dispozitat e tij përputhen me të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kushtetutë dhe në instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara. Ky ligj është i orientuar për të siguruar përputhshmërinë me parimet si ai i interesit më të mirë të fëmijës, të drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, si dhe të drejtën për procedura të drejta dhe transparente. Synimi i tij është përmirësimi i mbrojtjes për migrantët dhe anëtarët e familjes së tyre, refugjatët dhe azilkërkuarit. Ligji gjithashtu garanton të drejtën për qëndrim dhe punësim të ligjshëm në Shqipëri, përmes lejeve të qëndrimit dhe lejeve unike të kategorizuara, ofron akses në programe dhe shërbime integrimi, ndihmon në ofrimin e informacionit dhe procedurave të thjeshtuara për dokumente, dhe sigurimin e dokumenteve sipas standardeve ndërkombëtare.²⁰ Ligji gjithashtu parashikon të drejtën e ankimit në rrugë administrative sipas legjislativit në fuqi.

Risite e ligjit të ri për të huajt fokusohen në përmirësimin e mekanizmave të nevojshëm për lëshimin e vizave elektronike *on-line*, duke synuar zgjidhjen e problematikave të ndeshura gjatë zbatimit të ligjit të mëparshëm lidhur me pamundësinë për të mbuluar shumë vende me misione diplomatike apo poste konsullore. Ligji i ri plotëson një nga mangësitë e legjislativit të mëparshëm për të huajt, duke integruar pajisjen me leje unike, e cila garanton një procedurë të vetme të aplikimit për të huajt, që kanë për qëllim të punojnë dhe të qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, Ligji synon përmirësimin e dispozitave të lidhura me çështjen e punësimit të shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë, duke qartësuar afatet

¹⁷ Shih Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2024-2030, fq 3.

¹⁸ Shih po aty, fq 3.

¹⁹ Neni 1 i Ligjit Nr. 79 datë 18.10.2021 “Për të huajt”; <https://qbz.gov.al/share/h6NNRj6cQMey7WFnNu7wng>

²⁰ Kreu IV, Qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr. 79 datë 18.10.2021 “Për të huajt”; <https://qbz.gov.al/share/h6NNRj6cQMey7WFnNu7wng>

kohore dhe procedurat për t'u pajisur me leje unike, si dhe duke reduktuar pengesat e panevojshme për punësimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë.²¹

Ndër të tjera, nëpërmjet dispozitave të këtij ligji janë shtuar kategoritë e të huajve për t'u pajisur me leje qëndrimi të cilët kanë hasur vështirësi në të shkuarën për të qëndruar në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë vijon:

- Leje qëndrimi për personat pa shtetësi, duke garantuar një qëndrim të ligjshëm për këtë kategori;
- Leje qëndrimi për pensionistë, leje e cila do të mbulojë një hendek të ligjit aktual për të huajt, duke u siguruar shtetasve të huaj që janë në pension në vendin e tyre, mundësinë për të aplikuar për një leje qëndrimi për pensionistë, pranë autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin në Republikën e Shqipërisë, nëse preferojnë vendin tonë si një destinacion për të jetuar;
- Leje qëndrimi për punonjës lëvizës, të cilët janë shtetasit e huaj që punojnë në vende të ndryshme, jo në një zyrë apo seli të institucionit, dhe puna e tyre kryesisht është puna lëvizëse ku mjet kryesor pune kanë mjetet e teknologjisë së informacionit;
- Leje qëndrimi e përkohshme për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi në Republikën e Shqipërisë, procedurat dhe kriteret e së cilës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.²²

Ligji për të huajt ka parashikuar lejen e qëndrimit, kartën blu, bazuar në direktivën 2009/52/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 18 qershor 2009, "Mbi parashikimin e standardeve minimale të sanksioneve dhe masave ndaj punëdhënësve të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme". Karta Blu e BE-së shërben si leje pune dhe qëndrimi për shtetasit e vendeve jo anëtarë të Bashkimit Evropian me kualifikim të lartë, gjë që u lejon atyre të jetojnë dhe punojnë në Bashkimin Evropian. Kjo kartë është krijuar për të tërhequr në BE profesionistë me kualifikim të lartë nga vendet jo anëtare të BE-së, duke thjeshtuar procesin dhe duke përmirësuar statusin e tyre ligjor.

Me direktivën (BE) 2021/1883 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 20 tetor 2021 "Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime punësimi me kualifikim të lartë", leja e qëndrimit që njihet si karta blu në Bashkimin Evropian pësoi ndryshime. Sipas kësaj direktive parashikohen kushte më fleksibël pranimi për punëtorët e huaj të kualifikuar, veçanërisht për sa i përket pragut të pagës minimale, të drejtave të zgjeruara, kushteve më të favorshme për bashkim familjar dhe mundësisë për të udhëtuar dhe punuar më lehtë në shtetet e tjera anëtare të BE-së. Sipas *screening report* për vitin 2023 evidentohet se 'në fushën e migracionit të ligjshëm **janë të nevojshme ndryshime, veçanërisht për të**

²¹ Shih relacionin për projektligjin "Për të huajt",

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20210214210347RELACION%20-%20TE%20HUAJT.pdf>

²² Shih relacionin për projektligjin "Për të huajt",

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20210214210347RELACION%20-%20TE%20HUAJT.pdf>

përafruar disa dispozita mbi bashkimin familjar, me lejen e vetme (single permit) dhe me ndryshimet e fundit në kartën blu të BE-së.²³

Në lidhje me aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj, ato rregullojnë detajet e migracionit të rregullt dhe të parregullt. Konkretisht, ***Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021***²⁴, përcakton rregullat për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për hyrjen dhe qëndrimin e ligjshëm të të huajve në Shqipëri. Ky vendim lejon pajisjen me leje qëndrimi apo leje unike në Shqipëri, sipas motiveve dhe qëllimeve të aplikimit. ***Vendimi nr. 857, datë 29.12.2021***²⁵, si një bashkë propozim nga Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, miratoi ngritjen e Regjistrimit Elektronik Kombëtar për të Huajt (REKH) në Shqipëri. Ky regjistër do të mbledhë dhe përditëson të dhënat për shtetasit e huaj dhe për personat me qëndrim të parregullt në territorin shqiptar, duke ofruar informacion për të huajt që kanë vizë, leje qëndrimi, leje unike dhe ata me qëndrim të parregullt. Udhëzimet e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme përfshijnë trajtimin e të huajve të parregullt, sigurimin e asistencës në transit dhe organizimin e operacioneve të kthimit në rrugë ajrore, në përputhje me direktivat përkatëse.²⁶

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 159 datë 17.03.2023²⁷ është akti normativ për miratimin e formës dhe përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për të huajt pa shtetësi, të dokumentit të udhëtimit, lejes së kalimit, të dokumentit të përkohshëm, dublikatës së lejes së qëndrimit e të lejes unike, si dhe të letërnjoftimit për të huajt. Ndërkohë, ***Vendimi nr. 450 datë 29.06.2022*** përcakton formën dhe përmbajtjen e lejeve të qëndrimit për të huajt.²⁸

Shumë akte të tjera nënligjore janë miratuar për të rregulluar bashkëpunimin e strukturave përkatëse të migracionit dhe për të përcaktuar procedurat për zgjatjen e afatit të qëndrimit, regjistrimin në autoritetet lokale për kufirin dhe migracionin, si dhe për pajisjen me dokumente të ndryshme në rast humbjeje apo dëmtimi.

²³ Screening report 2023 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf

²⁴ VKM Nr. 858 datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë” e ndryshuar <https://qbz.gov.al/share/jkg1P7KaQSOm92Of53j6mg>

²⁵ Vendim Nr. 857, Datë 29.12.2021 Për Ngritjen dhe Funkionimin e Regjistrimit Elektronik Kombëtar për të Huajt në Republikën e Shqipërisë, <https://qbz.gov.al/share/duXrYVKUTjSQXOpKkWz0tw>

²⁶ Shih Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2024-2030, fq 4.

²⁷ VKM nr. 159 datë 17.03.2023 Për miratimin e formës e të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për të huajt pa shtetësi, të dokumentit të udhëtimit, lejes së kalimit, të dokumentit të përkohshëm, dublikatës së lejes së qëndrimit e të lejes unike, si dhe të letërnjoftimit për të huajt; <https://qbz.gov.al/share/6hrR2r9TSvaDIwvKO2uCiA>

²⁸ VKM nr. 450 datë 29.06.2022 Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejeve të qëndrimit për të huajt, <https://qbz.gov.al/share/u8mswoaDSee9hPPMxW5puw>

Në lidhje me zvogëlimin e pashtetësisë, është miratuar **Udhëzimi i Ministrisë të Brendshme nr. 87, datë 21.6.2023**²⁹, për dokumentacionin dhe procedurën e aplikimit për shpalljen e statusit të pashtetësisë. Ky udhëzim synon dhënien e statusit të pashtetësisë për individë që e kërkojnë këtë status, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore. Personat pa shtetësi mund të aplikojnë për leje qëndrimi për personat pa shtetësi, leje humanitare dhe dokument udhëtimi për këtë kategori, sipas legjislacionit në fuqi. Dokumenti i udhëtimit lejon udhëtimin dhe rikthimin në Shqipëri për një periudhë 2-vjeçare. Udhëzimi është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira, të ngjashme me procedurat për përcaktimin e statusit të refugjatëve. Ai përfshin garancitë procedurale për drejtësi dhe transparencë, si intervistë, ndihmë me përkthim, afatin për marrjen e vendimit, të drejtën për të marrë vendimin në formë të shkruar dhe të drejtën e ankimit. Procedurat për përcaktimin e pashtetësisë gjithashtu marrin parasysh nevojat e veçanta të aplikantëve, veçanërisht për ata që janë të mitur ose me aftësi të kufizuara, duke siguruar një pjesëmarrje të barabartë në procedura.

➡ Edhe **Ligji Nr. 10 2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”**³⁰, si një akt ligjor i përafuar me Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit apo konventat ndërkombëtare, në dispozitat e tij parashikon si të drejtë themelore të drejtën për azil, për të gjithë shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët ndodhen jashtë territorit të vendbanimit të tyre, por për arsye objektive si: frika e persekutimit për shkak të racës, besimit fetar, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar apo të bindjes politike, nuk kërkojnë mbrojtjen e atij vendi. Ndër parimet kryesore ku bazohet ky ligj, diktuar dhe nga Konventa e Gjenevës, vlen të përmendet parimi i moskthimit, ndërkohë që respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara dhe nga konventat e tjera ndërkombëtare, ndalimi i dëbimit, e drejta për lirinë nga tortura dhe trajtimi mizor, çnjerëzor dhe degradues, e drejta e procedurave dhe garancive ligjore për ndihmën juridike falas nga shteti, e drejta për kushtet minimale të jetesës, për kujdes shëndetësor, për arsimim, për punësim dhe trajnime profesionale, e drejta për bashkim familjar, për të pasur një përkthyes, apo dhe e drejta e ankimit, mbeten kryefjala e këtij Ligji.³¹

Në përmbushje të angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e mbrojtjes, Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, përcakton kushtet për dhënien e formave të ndryshme të mbrojtjes për azilkërkesit, duke përfshirë statusin e refugjatit, mbrojtjen plotësuese dhe të përkohshme. Miratimi i ligjit ka përafuar kuadrin shqiptar të mbrojtjes me standardet e përcaktuara në Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS). Ligji përcakton procedurën për shqyrtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare, duke kërkuar që të ekzistojnë kushtet e duhura për një vlerësim gjithëpërfshirës të arsyeve për dhënien e statusit të refugjatit ose njohjen e statusit të mbrojtjes plotësuese dhe vendosjen e afateve kohore për shqyrtimin e kërkesës. Përcaktohen nocionet “vend i sigurt i origjinës”, “vend i tretë i sigurt”,

²⁹ Udhëzim Nr. 87, Datë 21.6.2023 Mbi Dokumentacionin dhe Procedurën për Aplikimin, Vlerësimin, Miratimin dhe Refuzimin e Kërkesës për Shpalljen e Statusit të Pashtetësisë,

<https://qbz.gov.al/share/KjQwHywSRjyMlszwGFQkNw>

³⁰ Ligji Nr. 10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”,

https://qbz.gov.al/share/4XpgKq6lSdS_MIJqzKakmQ

³¹ ShihStrategjinë Kombëtare për Migracionin 2024-2030, fq 4.

“procedurë e përshpejtuar” dhe “aplikime dukshëm të pabazuara”. Përshkruhen rrethanat në të cilat një person humb statusin e mbrojtjes ndërkombëtare.³²

Ligji përcakton se në cilat kushte mund të kufizohet liria e lëvizjes së aplikantit ose mund të kryhet largimi i tij/saj nga territori i vendit. Parashikohen masa të dedikuara për të përballuar një trajtim të veçantë për personat që i përkasin kategorisë së veçantë, të përcaktuar përmes vlerësimit individual. Në veçanti, të miturve të pashoqëruar duhet t’u caktohet një kujdestar dhe t’u ofrohet strehim dhe kujdes i specializuar. Ligji përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatëve dhe përfituesve të mbrojtjes plotësuese. Brenda dy viteve nga marrja e mbrojtjes, refugjatët dhe personat që gëzojnë mbrojtje plotësuese kanë të drejtë për bashkim familjar nëse mund të dëshmojnë se kanë strehim të duhur, të ardhura të qëndrueshme dhe sigurim sëmundeje.³³

➡ Për ofrimin e zgjidhjeve të qëndrueshme për migrantët dhe garantimin e qëndrimit afatgjatë përmes shtetësisë shqiptare, **Ligji nr. 113/2020 “Për shtetësinë”**³⁴ ofron bazën ligjore. Ky ligj mundëson fitimin e shtetësisë shqiptare sipas kategorive dhe kushteve përkatëse (me lindje, origjinë, natyralizim, birësim, apo interes kombëtar në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës, ekonomisë, sportit). Ligji është ndryshuar në korrik 2023 për të mundësuar fitimin e shtetësisë shqiptare përmes natyralizimit të fëmijëve të mitur të shtetasve shqiptarë, edhe nëse nuk përmbushin kushtet për njohuri të gjuhës dhe historisë së Shqipërisë. Ndryshimet gjithashtu synojnë mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve dhe lehtësimin e bashkimit familjar, duke përjashtuar kërkesën për një periudhë qëndrimi të vazhdueshëm 7-vjeçar dhe për vlerësimin e njohurive të gjuhës shqipe dhe historisë së Shqipërisë.

Një ndryshim tjetër ligjor është bërë për të mundësuar përthithjen e talenteve të rinj që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeçare në fushat e interesit kombëtar, duke ulur kufirin e moshës për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programeve të veçanta të shtetësisë.

➡ **Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”**³⁵ rregullon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për të gjitha grupet e parashikuara në të. Ky ligj garanton mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi mundësish dhe shanseve për ushtrimin e të drejtave dhe pjesëmarrjen në jetën publike, si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi. Ai zbatohet për të gjithë personat që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Shqipërisë, përfshirë migrantët e rregullt dhe të parregullt.

Ndryshimet e miratuara në **Ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”**³⁶ i ngarkuan njësisive të vetëqeverisjes vendore (NJVV) përgjegjësi shtesë duke kërkuar ngritjen e një njësie të posaçme për diasporën dhe migracionin. Funkcionet e kësaj strukture përfshijnë ofrimin e mbështetjes,

³² Shih Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2024-2030, fq 4.

³³ Shih Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2024-2030,, fq 4.

³⁴ Ligji Nr. 113/2020 “Për Shtetësinë”, i ndryshuar https://qbz.gov.al/share/oTsG6arSRnCEU4gQ_6I7WQ

³⁵ Ligji Nr.10 221, Datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (Ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020, Datë 15.10.2020) <https://qbz.gov.al/share/IHdHbRxBRqLh6wR3FyWQ>

³⁶ Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (Ndryshuar me ligjin nr. 38/2019, datë 20.6.2019), https://qbz.gov.al/share/2-vAvQMvRkaPVz83f_eifg

➡ Informacionit dhe shërbimeve për migrantët në lidhje me mundësitë e investimit si dhe riintegrimin social të migrantëve të kthyer. Një funksion tjetër i NJVV-ve ka të bëjë me mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me emigrantët dhe diasporën nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të organizuara brenda dhe jashtë vendit. NJVV-të kërkohet të koordinojnë veprimtarinë e tyre me ministritë përgjegjëse për migracionin dhe punët e jashtme për të siguruar informacion dhe mbështetje për çështjet që lidhen me migracionin dhe diasporën.

➡ Në shkurt të vitit 2024, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar **Ligjin nr. 20/2024 “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”**,³⁷ Protokollin për Migracionin i cili ishte miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 622, datë 06.11.2013³⁸, është nënshkruar në të njëjtën datë nga kryeministrat respektivë në Romë, Itali. Protokollin për Migracionin ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit dypalësh për menaxhimin e flukseve migratore nga vendet e treta në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe atë evropiane. Sipas tij, pala shqiptare i njeh palës italiane të drejtën e përdorimit të disa pronave të paluajtshme në pronësi të shtetit (zona), pa kundërshtim, për të gjithë kohëzgjatjen e Protokollit për Migracionin, i cili do të mbetet në fuqi për pesë vjet, me të drejtë rinovimi, në formë të heshtur, për një periudhë tjetër pesëvjeçare. Ndërsa, pala italiane në këto zona mund të krijojë struktura për pritjen e migrantëve, të cilët nuk kanë të drejtë hyrjeje dhe qëndrimi në shtetin italian dhe numri i tyre nuk mund të jetë më i lartë se 3 000 veta. Këto struktura do të menaxhohen nga autoritetet italiane, sipas legjislacionit italian dhe evropian dhe mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet autoriteteve italiane dhe migrantëve që do të akomodohen në to, do t’i nënshtrohen ekskluzivisht juridiksionit italian.

Me depozitimin fillimisht të projektligjit për ratifikimin e protokollit, ky protokoll solli polemika të shumta duke bërë që 30 deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ti drejtohen Gjykatës Kushtetuese për deklarimin të papajtueshëm me Kushtetutën të Protokollit. Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 2 datë 29.01.2024³⁹ ka vendosur se Protokollin për Migracionin nuk çënon kufijtë territorialë të Shqipërisë dhe nuk prek integritetin e saj territorial, pasi nuk ka të bëjë me ndonjë ndryshim fizik të territorit. Në dy zonat ku Protokollin zbatohet, do të veprojnë e drejta shqiptare, krahas asaj italiane. Gjykata theksoi se e drejta ndërkombëtare për çështjet e migracionit dhe azilit është e zbatueshme edhe nga autoritetet italiane, pasi të dy shtetet kanë ratifikuar marrëveshjet përkatëse. Për më tepër, Gjykata nënvizoi se Shqipëria mban përgjegjësi për Protokollin, bazuar në normat kushtetuese dhe detyrimet ndërkombëtare. Në aspektin e të drejtave dhe lirive të njeriut, ekziston një juridiksion i dyfishtë, ku autoritetet italiane dhe shqiptare kanë përgjegjësi të përbashkëta, dhe prania e juridiksionit italian në zonat e caktuara nuk përjashton atë shqiptar.

³⁷ Ligjin nr. 20 datë 22.02.2024 “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”

<https://qbz.gov.al/share/fsz4uqAROLqB8bysyfHmaw>

³⁸ VKM nr. 622/2013 “Për miratimin, në parim, të Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”

³⁹ Vendim nr. 2 datë 29.01.2024 (V-2/24), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

https://www.gjk.gov.al/include_php/previewdoc.php?id_kerkesa_vendimi=3990&nr_vendim=1

3.3 Standardet ndërkombëtare dhe evropiane

3.3.1 Standardet ndërkombëtare sipas Kombeve të Bashkuara

Menaxhimi i duhur i migracionit mbetet një prioritet kryesor edhe për perspektivën e integritimit të vendit në BE. Përgjithësisht, Shqipëria vazhdon të jetë një vend origjine për migrantët ekonomikë, por është gjithashtu një vend tranziti dhe destinacioni për migrantët ekonomikë, azilkërkuesit dhe refugjatët. Shqipëria ka një kuadër ligjor të plotë sa i takon garantimit të të drejtave të migrantëve, ku përfshihet dhe zbatimi i të drejtave themelore për punëtorët migrantë dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilat mbrohen nëpërmjet dispozitave të kuadrit ligjor kombëtar dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, veçanërisht instrumenteve, të tilla si:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjes së tyre (ICRMW);
- Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) nr. 97 dhe nr. 143;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC);
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR);
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR);
- Konventa e vitit 1951 mbi Statusin e Refugjatëve dhe protokollin e saj i vitit 1967;
- Konventa për Statusin e Personave pa Shtetësi;
- Konventa mbi Zvogëlimin e Pashtetësisë;
- Kompakti Global për migracionin;
- Strategjia e BE-së për Kthimin Vullnetar dhe Riintegrimin.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut - Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) parashikon që të gjithë individët, pavarësisht nga kombësia apo statusi, përfshirë të huajt dhe refugjatët, kanë të drejtën e trajtimit të barabartë dhe të mbrojtjes nga diskriminimi. Neni 14 thekson të drejtën e individëve për të kërkuar dhe për të gëzuar azil nga persekutimi në vende të tjera. Gjithashtu, neni 13 garanton lirinë e lëvizjes dhe të zgjedhjes së vendbanimit brenda çdo shteti, si dhe të drejtën për t'u larguar nga çdo vend, përfshirë vendin e vet, dhe për t'u kthyer në të. Këto parashikime mbështesin mbrojtjen e refugjatëve dhe të huajve, duke u siguruar atyre të drejta themelore, pavarësisht nga statusi juridik.⁴⁰

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjes së tyre (ICRMW)⁴¹ - e miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1990, synon të mbrojë të drejtat e punëtorëve migrantë dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor. Ajo garanton të drejta themelore si mbrojtja nga

⁴⁰ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut - <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524735491-DEKLARATA-UNIVERSALE-E-TE-DREJTAVE-TE-NJERIUT.pdf>

⁴¹ Ligji Nr.9703, datë 2.4.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre” https://qbz.gov.al/share/48J_m76XR6eJNMCKk6Xdrw

diskriminimi, trajtimi i drejtë në kushte pune, të drejtën për qasje në kujdes shëndetësor, arsim dhe shërbime sociale. Konventa gjithashtu kërkon që shtetet të promovojnë mirëqenien e punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre, si dhe të sigurojnë respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të tyre njerëzore në të gjitha fazat e migracionit. Kjo konventë nxit trajtim të drejtë dhe dinjitoz për punëtorët migrantë, duke njohur kontributin e tyre në shoqëritë pritëse dhe ato të origjinës.

Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) nr. 97 dhe nr. 143 - janë dy instrumente ndërkombëtare që synojnë të mbrojnë të drejtat e punëtorëve migrantë dhe të promovojnë menaxhimin e drejtë të migracionit të punës. **Konventa nr. 97**⁴², e miratuar në vitin 1949, ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes për punëtorët migrantë. Ajo parashikon që punëtorët migrantë të trajtohen në mënyrë të barabartë me shtetasit vendas në lidhje me kushtet e punës, pagat, mbrojtjen sociale dhe qasjen në shërbime mjekësore. Gjithashtu, kërkon që shtetet të bashkëpunojnë për të luftuar migracionin e paligjshëm dhe të rregullojnë kushtet e migracionit. **Konventa nr. 143**,⁴³ e miratuar në vitin 1975, përqendrohet në luftimin e abuzimeve që lidhen me migracionin e parregullt dhe në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë, pavarësisht nga statusi i tyre. Ajo thekson rëndësinë e ndihmës për integrimin e punëtorëve migrantë në vendin pritës dhe nxit mbrojtjen e të drejtave të tyre, përfshirë qasjen e barabartë në punë, arsim, dhe trajtim dinjitoz. Të dy konventat promovojnë parimin e trajtimit të barabartë dhe mbrojtjen e të drejtave themelore për punëtorët migrantë, duke mbështetur migracionin e sigurt dhe të rregulluar.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC)⁴⁴ - e miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1989, është një instrument ndërkombëtar që përcakton të drejtat themelore të çdo fëmije, pavarësisht nga kombësia, statusi apo gjendja ekonomike. Konventa përfshin katër parime kryesore: mosdiskriminimi, interesi më i lartë i fëmijës, e drejta për të jetuar dhe zhvilluar, dhe pjesëmarrja e fëmijës në vendime që ndikojnë jetën e tij. Ajo mbron të drejtat e fëmijëve në fusha të ndryshme, përfshirë të drejtën për arsim, shëndetësi, mbrojtje nga abuzimi dhe shfrytëzimi, si dhe të drejtën për të pasur një familje. Konventa kërkon që shtetet të ndërmarrin masa për të mbrojtur fëmijët në situata të rrezikut, si fëmijët refugjatë, ata të ndarë nga familjet e tyre, ose ata të përfshirë në punë të detyruar dhe trafikim. Ajo siguron që çdo fëmijë të trajtohet me dinjitet dhe respekt, duke theksuar detyrimin e shteteve për të siguruar mirëqenien dhe zhvillimin e tyre të plotë.

⁴² C097 - Migration for Employment Convention (Revised), 1949 (No. 97) https://normlex.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:55:0::NO::P55_TYPE,P55_LANG,P55_DOCUMENT,P55_NODE:CON,en,C097./Document

⁴³ C143 - Migrant Workers (Supplementary Provisions) Convention, 1975 (No. 143) https://normlex.ilo.org/dyn/normlex/es/f?p=NORMLEXPUB:55:0::NO::P55_TYPE,P55_LANG,P55_DOCUMENT,P55_NODE:SUP,en,C143./Document

⁴⁴ <https://www.unicef.org/child-rights-convention/convention-text>

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)⁴⁵ - i miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1966, është një instrument thelbësor që garanton dhe mbrojnë të drejtat themelore civile dhe politike për të gjithë individët, pavarësisht nga kombësia apo statusi. Pakti përmban një gamë të gjerë të drejtash, duke përfshirë të drejtën për jetën, lirinë nga tortura, lirinë e mendimit, shprehjes, dhe fesë, si dhe të drejtën për një proces të drejtë ligjor. ICCPR gjithashtu parashikon të drejtën për lirinë e lëvizjes, të drejtën për pjesëmarrje në jetën publike dhe zgjedhje, dhe mbrojtjen nga arrestimi apo ndalimi arbitrar. Dokumenti është i rëndësishëm për të siguruar barazinë para ligjit dhe për të luftuar diskriminimin mbi bazën e racës, gjinisë, fesë apo origjinës. Pakti vendos obligime për shtetet pjesëmarrëse që të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e individëve në territorin e tyre dhe të krijojnë mekanizma për mbrojtjen dhe zbatimin e këtyre të drejtave.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR)⁴⁶ - i miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1966, synon të mbrojë dhe promovojë të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të individëve, duke njohur rëndësinë e barazisë dhe mirëqenies për të gjithë. Ky pakt thekson të drejtat themelore si e drejta për punë, të drejtën për kushte të drejta dhe të sigurta të punës, të drejtën për edukim, e drejta për një standard të përshatshëm jetese, dhe të drejtën për kujdes shëndetësor. ICESCR kërkon nga shtetet pjesëmarrëse të përmbushin dhe të promovojnë gradualisht këto të drejta përmes marrjes së masave ekonomike dhe sociale, duke marrë parasysh burimet e tyre të disponueshme. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është të drejtat kulturore, përfshirë të drejtën e individëve për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe për të gëzuar përfitimet e përparimeve shkencore. Ky pakt nënvizon detyrimin e shteteve për të luftuar varfërinë, për të siguruar arsimim të cilësisë së lartë dhe qasje në kujdes shëndetësor për të gjithë, duke mbështetur zhvillimin ekonomik dhe social në një mënyrë që përmirëson mirëqenien e përgjithshme të popullsisë.

Konventa e vitit 1951 mbi Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin e saj i vitit 1967⁴⁷ - janë dokumente themelore ndërkombëtare që përcaktojnë standardet për mbrojtjen e refugjatëve në mbarë botën. *Konventa e vitit 1951* përcakton një definicion të qartë për refugjatët, duke i përkufizuar ata si individë që ndodhen jashtë vendit të tyre të origjinës dhe kanë frikë të bazuar përndjekje për arsye të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë në një grup të caktuar shoqëror apo opinionit politik. Një nga parimet kryesore të kësaj konvente është parimi i moskthimit ("non-refoulement"), që ndalon kthimin e refugjatëve në një vend ku jeta apo liria e tyre mund të jenë në rrezik. Gjithashtu, konventa siguron të drejta të rëndësishme për refugjatët, përfshirë të drejtën për qasje në arsim, punësim, dhe strehim, si dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe ndalimi arbitrar. *Protokollin e vitit 1967* zgjeroi fushën e veprimit të konventës duke hequr kufizimet

⁴⁵ <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights>

⁴⁶ International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights. Adopted by General Assembly Resolution 2200A (XXI) on 16 December 1966, United Nations General Assembly.

<https://www.ohchr.org/sites/default/files/cescr.pdf>

⁴⁷ Convention And Protocol Relating To The Status of Refugees <https://www.unhcr.org/media/convention-and-protocol-relating-status-refugees>

gjeografike dhe të periudhës kohore të përcaktuara në tekstin original, duke e bërë atë të zbatueshme për refugjatët në të gjithë botën, pavarësisht se kur ose ku kanë ndodhur ngjarjet që i detyruan ata të kërkojnë azil. Këto instrumente ndërkombëtare kanë krijuar një bazë të fuqishme ligjore për mbrojtjen e refugjatëve dhe detyrimet e shteteve për t'u siguruar atyre mbrojtje dhe mbështetje.

Konventa për Statusin e Personave pa Shtetësi⁴⁸ - e miratuar në vitin 1954 nga Kombet e Bashkuara, ka për qëllim të mbrojë dhe të përmirësojë kushtet e jetesës për individët që nuk kanë shtetësi. Persona pa shtetësi janë ata që nuk njihen si shtetas nga asnjë shtet sipas ligjit të atij shteti, duke i lënë pa mbrojtje juridike dhe shpesh pa qasje në të drejtat themelore. Konventa garanton që personat pa shtetësi të kenë të drejta të ngjashme me ato të refugjatëve dhe shtetasve të vendeve pritëse, përfshirë të drejtën për qasje në arsim, punësim, dhe strehim, si dhe mbrojtjen nga dëbimi. Ajo përcakton të drejtën e personave pa shtetësi për dokumente udhëtimi, që u mundësojnë të lëvizin lirshëm, dhe përmban udhëzime për përmirësimin e statusit të tyre ligjor. Konventa gjithashtu kërkon që shtetet të punojnë drejt uljes së numrit të personave pa shtetësi përmes regjistrimeve të lindjeve, natyralizimeve, dhe përpjekjeve për të parandaluar krijimin e mëtejshëm të statusit të pa shtetësisë, duke mbrojtur të drejtat e këtyre individëve dhe duke siguruar integritetin e tyre të suksesshëm në shoqëri.

Konventa mbi Zvogëlimin e Pashtetësisë⁴⁹ - e miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1961, synon të reduktojë rastet e pashtetësisë dhe të parandalojë krijimin e mëtejshëm të këtij statusi. Pashtetësia ndodh kur një individ nuk është i njohur si shtetas nga asnjë shtet, duke i lënë ata pa mbrojtje juridike dhe shpesh pa qasje në të drejta të rëndësishme civile dhe sociale. Konventa vendos detyrime për shtetet anëtare që të sigurojnë marrjen e shtetësisë për individët në situata të caktuara, si për shembull fëmijët e lindur në territorin e tyre që prindërit do të mbeteshin pa shtetësi, dhe ata që e humbasin shtetësinë për shkak të humbjes së shtetësisë së prindërve. Ajo nxit shtetet që të parandalojnë heqjen e shtetësisë për individët në mënyrë arbitrare dhe të ndihmojnë personat që prindërit do të mbeteshin pa shtetësi përmes proceseve të natyralizimit. Një aspekt i rëndësishëm i konventës është parimi që askush nuk duhet të mbetet pa shtetësi për shkak të racës, fesë, etnisë apo faktorëve të tjerë diskriminues. Ajo synon të sigurojë që shtetësia të mos humbet në mënyrë të padrejtë dhe që të minimizohet ndikimi i pashtetësisë, duke garantuar respektimin e të drejtave themelore të individëve.

Kompakti Global për Migracionin (Global Compact for Safe, Orderly and Regular Migration)⁵⁰ - i miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2018, është marrëveshja e parë ndërkombëtare që synon të rregullojë dhe të përmirësojë menaxhimin e migracionit në nivel global. Ky dokument jo-detyrues përmban një sërë parimesh dhe objektivash që synojnë të mbështesin migracionin e sigurt, të rregullt dhe të parashikueshëm, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe sovranitetin kombëtar. Kompakti ka 23 objektiva që përfshijnë fusha si: zvogëlimi

⁴⁸Convention relating to the Status of Stateless Persons

https://treaties.un.org/doc/Treaties/1960/06/19600606%2001-49%20AM/Ch_V_3p.pdf

⁴⁹Convention on the Reduction of Statelessness 1961

https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/6_1_1961.pdf

⁵⁰<https://www.iom.int/global-compact-migration>

i faktorëve që detyrojnë njerëzit të migrojnë, sigurimi i qasjes në dokumente identifikimi dhe mbrojtje ligjore, luftimi i trafikimit dhe shfrytëzimit të migrantëve, përmirësimi i integritetit të migrantëve në vendet pritëse, dhe promovimi i një migracioni të sigurt përmes kanaleve të rregullta. Ai gjithashtu thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për të ndihmuar në menaxhimin e sfidave të migracionit. Një aspekt i rëndësishëm i Kompaktit është qasja e tij ndaj mbrojtjes së dinjitetit dhe të drejtave të migrantëve, duke përfshirë të drejtat për qasje në shërbime bazë si arsim, shëndetësi dhe strehim, pavarësisht nga statusi i tyre. Ai synon të reduktojë rreziqet dhe pasiguritë që përballen migrantët gjatë rrugëtimit të tyre, dhe nxit integritimin dhe përfshirjen shoqërore të tyre në vendet pritëse.

3.3.2. Standardet ndërkombëtare sipas të drejtës Evropiane

Në nivel evropian, ka disa akte dhe instrumente që rregullojnë të drejtat e të huajve, përfshirë emigrantët, refugjatët dhe personat pa shtetësi. Ndër aktet më të rëndësishme mund të përmendim:

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR)⁵¹ - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) parashikon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë individët në territorin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, përfshirë të huajt dhe refugjatët. Ajo garanton të drejta të rëndësishme si e drejta për jetën, e drejta për mbrojtje nga tortura dhe trajtimi i keq, e drejta për një proces të drejtë ligjor, dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. Konventa ndalon gjithashtu diskriminimin dhe ofron mbrojtje për individët pa marrë parasysh statusin e tyre ligjor. Në veçanti, neni 3 ndalon trajtimin jo njerëzor dhe degradues, i cili është veçanërisht i rëndësishëm për refugjatët dhe të huajt në situata të rrezikshme. Gjithashtu, neni 4 mbron nga detyrimi për të punuar në kushte të shkeljes së të drejtave dhe neni 8 mbështet të drejtën për të kërkuar azil dhe për të ruajtur integritetin e jetës private dhe familjare. Kështu, ECHR ofron një mbrojtje të gjerë dhe të fuqishme për të gjithë individët që ndodhen në juridiksionin e shteteve anëtare, duke kontribuar në sigurinë dhe dinjitetin e të huajve dhe refugjatëve. E miratuar në vitin 1950, kjo konventë është një instrument thelbësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore në Evropë. Ajo ndalon diskriminimin dhe garanton të drejta të rëndësishme për të gjithë individët në territorin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, përfshirë të huajt.

Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian – e shpallur në vitin 2000 dhe e bëra e detyrueshme me Traktatin e Lisbonës në vitin 2009, Karta mbron të drejtat themelore të individëve në Bashkimi Evropian (BE). Ajo përfshin të drejtat e lidhura me lirinë, mbrojtjen nga diskriminimi, të drejtat sociale dhe ekonomike, përfshirë kombësinë dhe statusin e emigrantëve. Ajo ndihmon në harmonizimin e legjislacionit të BE-së dhe siguron mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të individëve që ndodhen në territoret e shteteve anëtare, duke forcuar angazhimin për respektimin e të drejtave themelore në të gjitha veprimet e BE-së.

⁵¹ European Convention on Human Rights https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Convention_ENG

Direktiva për Procedurat e Azilit (2013/32/EU) – Direktiva për Procedurat e Azilit (2013/32/EU)⁵² - e miratuar nga Bashkimi Evropian në vitin 2013, përcakton standardet për shqyrtimin e kërkesave për azil në shtetet anëtare të BE-së. Ajo synon të sigurojë që procedurat e azilit të jenë të drejtë, efikase dhe të harmonizuara në të gjitha shtetet anëtare. Kërkesat për azil duhet të shqyrtohen në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, duke garantuar qasje në shërbime të rëndësishme për kërkuessit. Direktiva ndalon vendosjen e kushteve që ndikojnë negativisht në mirëqenien e kërkuessve. Ajo kërkon që individët të kenë mundësi të paraqesin provat dhe të marrin këshillim ligjor. Ka dispozita për procedura të shpejta dhe të shkurtuara në raste të caktuara. Kërkuessit e azilit nuk mund të dëbohen deri sa të merret një vendim përfundimtar. Direktiva ndihmon në harmonizimin e praktikave të azilit në të gjithë BE-në. Ajo kontribuon në mbrojtjen dhe trajtimin e drejtë të individëve që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Përmes kësaj direktive, BE përpiket të përmirësojë sistemin e azilit dhe të sigurojë standarde të barabarta për të gjithë kërkuessit.

Direktiva për Kualifikimin (2011/95/EU)⁵³ - e miratuar nga Bashkimi Evropian në vitin 2011, përcakton standardet për njohjen e statusit të refugjatëve dhe mbrojtjen e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në shtetet anëtare të BE-së. Ajo vendos kriteret për të përcaktuar se kush mund të cilësohet si refugjat dhe siguron mbrojtje për ata që janë në rrezik të përndjekjes ose kanë nevojë për mbrojtje të plotë. Direktiva përfshin definicionin e refugjatëve sipas Konventës së vitit 1951 dhe shpërndan standarde për vlerësimin e kërkesave për azil. Ajo gjithashtu garanton të drejtat e refugjatëve, përfshirë aksesin në mbrojtje ligjore, arsim dhe shëndetësi. Ka rregulla të veçanta për mbrojtjen e personave që përballen me rrezik të rëndë, si tortura dhe trajtim i keq. Direktiva kërkon harmonizimin e praktikave të mbrojtjes ndërkombëtare në të gjithë BE-në dhe siguron standarde të njëjta për të gjitha shtetet anëtare. Ajo ndihmon në përmirësimin e mbrojtjes për refugjatët dhe përputhshmërinë e ligjeve të azilit në të gjithë Bashkimin Evropian. Përmes kësaj direktive, BE synon të sigurojë një sistem të drejtë dhe efikas për mbrojtjen e individëve që kërkojnë azil.

Direktiva për Pranimin e Të Huajve (2013/33/EU)⁵⁴ - e miratuar nga Bashkimi Evropian në vitin 2013, përcakton standardet për kushtet e jetesës së kërkuessve të azilit në shtetet anëtare të BE-së. Ajo siguron që këta individë të kenë kushte të arsyeshme dhe humane gjatë periudhës së shqyrtimit të kërkesës së tyre, duke përfshirë strehim të sigurt, ushqim, dhe akses në shërbime shëndetësore dhe arsimore. Direktiva garanton gjithashtu qasje në ndihmë sociale dhe materiale, mbështetje për integrimin, dhe mbikëqyrje për të siguruar që standardet janë të

⁵² Directive 2013/32/EU of the European Parliament and of the Council of 26 June 2013 on common procedures for granting and withdrawing international protection

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=celex%3A32013L0032>

⁵³ Directive 2011/95/EU of 13 December 2011 on standards for the qualification of third-country nationals or stateless persons as beneficiaries of international protection, for a uniform status for refugees or for persons eligible for subsidiary protection, and for the content of the protection granted

<https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2011/95/oj>

⁵⁴ Directive 2013/33/EU of the European Parliament and of the Council of 26 June 2013 laying down standards for the reception of applicants for international protection <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32013L0033>

përmbushura. Ajo ndalon dëbimin e kërkuësve në vende ku mund të rrezikohen nga përndjekja ose trajtimi i keq dhe siguron që ata të kenë mundësi të kontribuojnë në shqyrtimin e kërkesës së tyre. Në këtë mënyrë, direktiva ndihmon në krijimin e kushteve të barabarta dhe të ndershme për kërkuësit e azilit në të gjithë BE-në.

Direktiva për Të Drejtën e Lirisë dhe të Lëvizjes (2004/38/EC)⁵⁵ - e miratuar nga Bashkimi Europian në vitin 2004, garanton që shtetasit e BE-së dhe anëtarët e familjeve të tyre kanë të drejtën të lëvizin dhe të qëndrojnë në çdo shtet anëtar për një periudhë të gjatë. Ajo lejon që shtetasit e BE-së dhe familjarët e tyre të qëndrojnë në çdo shtet anëtar për deri në 90 ditë pa kërkesa të veçanta, dhe për qëndrime më të gjata, ata duhet të regjistrohen dhe të përmbushin kushte si të kenë burime të mjaftueshme dhe sigurim shëndetësor. Direktiva ofron mbrojtje nga dëbimi dhe siguron akses në të drejtat dhe shërbimet në vendin e pritjes, duke përfshirë arsimimin dhe shëndetësinë. Ajo gjithashtu garanton që anëtarët e familjes, që nuk janë shtetas të BE-së, mund të bashkohen dhe të qëndrojnë me qytetarët e BE-së nën kushte të caktuara. Në këtë mënyrë, direktiva ndihmon në sigurimin e lirisë së lëvizjes dhe integrimin e shtetasve të BE-së në shtetet anëtare.

Strategjia e BE-së për Kthimin Vullnetar dhe Riintegrimin⁵⁶ - e publikuar në vitin 2021, synon të përmirësojë procesin e kthimit dhe riintegrimin të individëve që nuk kanë të drejtë të qëndrojnë në BE, duke promovuar një sistem të përbashkët dhe të koordinuar të kthimit. Strategjia fokusohet në forcimin e mbështetjes për riintegrimin dhe rritjen e pronësisë nga vendet e origjinës për këtë proces. Ajo identifikon disa sfida, si mangësitë në kapacitetet dhe shërbimet publike në vendet e origjinës, që ndikojnë negativisht në efektivitetin e riintegrimin. Mungesa e koordinimit dhe cilësisë së shërbimeve, si kujdesi shëndetësor, trajnimi dhe punësimi, mund të pengojë aksesin në mbështetje për individët e rikthyer. Strategjia kërkon që BE-ja të nxisë një rritje graduale të rolit të vendeve të origjinës në nismat e riintegrimin dhe të përfshijë shoqërinë civile dhe sektorin privat për të rritur efektivitetin. FRONTEX-i do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve për kthimin dhe riintegrimin, duke ndihmuar në organizimin e ripranimeve dhe ndërtimin e kapaciteteve vendore. BE-ja do të mbështesë zhvillimin e strukturave të qeverisjes së migracionit dhe do të ndihmojë në krijimin e qendrave të integruara të shërbimit publik në vendet e origjinës. Dialogu strategjik dhe menaxhimi i informacionit do të përdoren për të përmirësuar cilësinë e referimeve dhe për të maksimizuar përdorimin e burimeve në programet e riintegrimin.

⁵⁵ Directive 2004/38/EC of the European Parliament and of the Council of 29 April 2004 on the right of citizens of the Union and their family members to move and reside freely within the territory of the Member States amending Regulation (EEC) <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32004L0038>

⁵⁶ Strategjia e BE-së për Kthimin dhe Riintegrimin Vullnetar, Bruksel, 120 final, 27 prill 2021 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52021DC0120&qid=1632401748181>

IV. Procedurat për përfitimin e vizës dhe lejes së qëndrimit për të huajt

4.1. Procedura për pajisjen me vizë

Referuar Ligjit Nr. 79 datë 18.10.2021 “Për të huajt”, “Vizë” është autorizimi në formën e një vize pullë në një dokument të vlefshëm udhëtimi ose vizë elektronike, e printuar nga format elektronik, lëshuar nga autoritetet përgjegjëse, sipas procedurave të këtij ligji, që lejon të huajin të hyjë, të qëndrojë ose të kalojë transit në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.⁵⁷

Llojet e vizave dhe procedura për marrjen e tyre janë të rregulluara me ligj dhe përfshijnë disa kategori kryesore:

Viza e tipit “A”: Kjo vizë konsiderohet si viza e tranzitit në aeroport dhe u lejon mbajtësve të hyjnë dhe të qëndrojnë në zonën ndërkombëtare të aeroportit për të vazhduar udhëtimin drejt destinacionit të tyre. Viza e tipit “A” mund të jepet me shumë hyrje-dalje dhe me vlefshmëri maksimumi deri në gjashtë muaj, nëse aplikuesi është i besueshëm apo ka përdorur me korrektesë vizat e mëparshme dhe provon se ka nevojë të kalojë transit shpesh ose rregullisht. Aplikuesit mund të përjashtohen nga kjo vizë në disa raste, për shembull, mbajtësit e pasaportave diplomatike ose anëtarët e ekuipazheve të transportit ajror të cilët janë shtetas të një pale kontraktuese të Konventës së Çikagos mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, si dhe Konventës së Detit Montego Bay, apo thjeshtë i përkasin një kategorie që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me vizë.⁵⁸

Viza e tipit “C”: Kjo vizë lëshohet në formën e një vize pullë ose e printuar në format elektronik, e cila i jep të drejtën mbajtësit të saj të hyjë dhe të qëndrojë në RSH deri në 90 ditë brenda 180 ditëve, duke filluar nga data që aplikuesi ka hyrë për herë të parë. Mund të lëshohet me një, dy, ose shumë hyrje, por *periudha e vlefshmërisë nuk mund t’i kalojë 5 vjet*. Kjo vizë mund të përdoret për qëllime të ndryshme si turizmi, biznesi, apo angazhimeve familjare, dhe mund të përfshijë vizë grupi për aktivitete të përbashkëta (artistike, shkencore apo sportive). Viza e tipit “C” me një hyrje mund të jepet edhe si vizë grupi e hedhur në një pasaportë grupi, me qëllim transiti ose qëndrimi maksimalisht deri 30 ditë dhe për 5 deri në 50 persona, të cilët kanë për qëllim të marrin pjesë në aktivitete artistike, shkencore ose sportive, apo kur hyjnë dhe dalin nga territori së bashku si turistë. Kjo vizë grupi u lëshohet me kufizime rajonale ekuipazheve të mjeteve të lundrimit, të cilat transferohen në ose nga një anije së bashku.⁵⁹

Viza e tipit “D”: Kjo vizë lëshohet në formën e një vize pullë ose e printuar në format elektronik për shtetasit e huaj që synojnë të qëndrojnë në RSh më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve, dhe kur, për t’u pajisur me leje qëndrimi, për këta shtetas kërkohet vizë. Kjo vizë mund

⁵⁷ Shih nenin 3, pika 56 i Ligjit Nr. 79 datë 18.10.2021 “Për të huajt”;

⁵⁸ Për më shumë shih Nenin 19, të ligjit Nr. 79 datë 18.10.2021 “Për të huajt”.

⁵⁹ Për më shumë shih Nenin 20 të ligjit Nr. 79 datë 18.10.2021 “Për të huajt”.

të jepet edhe me vlefshmëri 1-vjeçare, kohë qëndrimi 90 ditë, por jo për më shumë se 180 ditë, llogaritur që nga dita e hyrjes së parë, me një, dy apo më shumë hyrje-dalje, e cila i jep të drejtë mbajtësit të aplikojë për t'u pajisur me leje qëndrimi pas hyrjes në Republikën e Shqipërisë.⁶⁰

Kriteret dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë dhe leje qëndrimi janë të përcaktuar qartë me **Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 858 datë 29.12.2021** "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë" e ndryshuar⁶¹.

Autoritetet përgjegjëse për pajisjen e të huajve me viza për hyrje, qëndrim ose transit në Shqipëri, është Ministria përgjegjëse për punët e jashtme e cila bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për rendin e sigurinë publike dhe Shërbimin Informativ të Shtetit lidhur me procedurën e lëshimit të vizave.

- **Aplikimi dhe lëshimi i vizës**

Neni 23 i ligjit "Për të huajt" rregullon procedurat për aplikimin për vizë për të huajt që dëshirojnë të hyjnë në Republikën e Shqipërisë. Sipas këtij neni, për pajisje me vizë, **aplikimi bëhet jo më shumë se 90 ditë përpara datës së planifikuar për të ardhur në RSH**, pranë përfaqësive diplomatike dhe/ose konsullore të RSH jashtë vendit në mënyrë elektronike ose, në rastet e marrëveshjeve me vende të tjera, në përfaqësitë përkatëse të këtyre vendeve. Aplikimi për të miturit duhet të nënshkruhet nga prindërit ose kujdestari ligjor, dhe të miturit duhet të pajisen me vizë në pasaportën e tyre personale. Nëse për arsye ligjore, një i mitur nuk mund të ketë pasaportë në vendin e tij të origjinës, viza e tij mund të regjistrohet në pasaportën e prindit ose kujdestarit.

Shtetasi i huaj duhet të aplikojë personalisht në konsullatë ose *online*, dhe nëse nuk ka një përfaqësi diplomatike shqiptare në vendin ku ai banon, kërkesa mund të bëhet *online* ose me postë në një përfaqësi diplomatike të autorizuar. **Dokumenti i udhëtimit i të huajit duhet të jetë i vlefshëm të paktën tre muaj pas largimit nga Shqipëria, të ketë dy faqe bosh dhe të jetë lëshuar brenda dhjetë viteve të fundit.**⁶²

Lëshimi i vizës për hyrje në RSH realizohet nga përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore të Shqipërisë ose përfaqësitë e vendeve të treta sipas marrëveshjeve ndërkombëtare. Vizat, qoftë ato të stampuara në pasaportë apo elektronike, jepen vetëm pasi ka përfunduar procedura e vlerësimit të kërkesës, që kryhet nga autoritetet përkatëse brenda një periudhe deri në 15 ditë, e cila mund të zgjatet deri në 30 ditë në raste të veçanta. **Megjithatë, pajisja me vizë nuk garanton automatikisht hyrjen në vend.**⁶³

⁶⁰ Për më shumë shih Nenin 20 të ligjit Nr. 79 datë 18.10.2021 "Për të huajt".

⁶¹ VKM Nr. 858 datë 29.12.2021 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë" e ndryshuar <https://qbz.gov.al/share/jkg1P7KaQSOm92Qf53j6mg>

⁶² Nenin 23 i ligjit Nr. 79 datë 18.10.2021 "Për të huajt".

⁶³ Nenin 24, pika 4 e ligjit Nr. 79 datë 18.10.2021 "Për të huajt".

Në raste përjashtimore, një vizë mund të lëshohet edhe në kufi nga autoritetet vendore për kufirin dhe migracionin, për ata të huaj që nuk kanë pasur mundësi reale të aplikojnë paraprakisht për vizë dhe që përmbushin disa kritere të caktuara. Këto viza kanë një afat deri në **15 ditë** dhe jepen në rrethana si emergjenca natyrore, aksidente, vdekje apo sëmundje të anëtarëve të familjes, si dhe për ekuipazhet e anijeve apo avionëve që përballen me probleme teknike ose mot të keq. Për këta persona, nuk kërkohet siguracion shëndetësor, përveç rasteve humanitare. Nëse konsiderohet e nevojshme, pajisja me vizë në kufi mund të refuzohet, dhe i huaji ka të drejtë të ankohet për këtë vendim. Procedurat e lëshimit të vizës në kufi janë të përcaktuara nga një udhëzim i përbashkët mes disa ministrive dhe autoriteteve shtetërore.⁶⁴

Sa i përket afatit të qëndrimit, në raste përjashtimore autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin zgjat afatin e qëndrimit të përcaktuar në vizën e lëshuar apo afatin e lejuar të qëndrimit pa vizë, nëse i huaji kërkon zgjatjen e qëndrimit para përfundimit të afatit të vlefshëm të qëndrimit, vetëm për arsye serioze personale, motive që vlerësohen të një rëndësie të veçantë, një force madhore ose humanitare, kur i huaji nuk ka pasur mundësi të largohet nga territori.

- **Anullimi dhe refuzimi i vizës**

Ka dhe raste të përlegjura kur viza mund të anulohet apo refuzohet nga autoriteti përgjegjës. Në çdo rast viza mund të anulohet nga ambasadat, postet konsullore, ose autoritetet përgjegjëse kur ajo është lëshuar në kundërshtim me ligjin, me dokumente të falsifikuara, ose nëse i huaji shpallet person i padëshiruar. Anulimi mund të bëhet edhe nga autoritetet kufitare kur i huaji nuk përmbush më kushtet e vizës. Arsyeja e anulimit i njoftohet menjëherë dhe i huaji ka të drejtën e ankimit.

Refuzimi i vizës ndodh kur aplikuesi nuk plotëson kushtet e qëndrimit, paraqet dokumente të falsifikuara, nuk ka burime financiare të mjaftueshme, ose konsiderohet kërcënim për sigurinë. Vendimi për refuzim i komunikohet të huajit, i cili ka të drejtën e ankimit ose mund të riaplikojë pas tre muajsh.

Nga ana tjetër në VKM Nr. 858 datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë” e ndryshuar është përcaktuar edhe lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në RSH. Të huajt e përjashtuar nga detyrimi i pajisjes me vizë kanë të drejtë të hyjnë dhe të qëndrojnë nëpër një afat deri në 90 ditë brenda 180 ditëve nga hyrja, përveç rasteve kur në marrëveshje ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe në fuqi ose bazuar në parimin e reciprocitetit apo qëndrimin e njëanshëm, të shprehur me vendim të Këshillit të Ministrave, parashikohet ndryshe.

Referuar rasteve të hyrjes pa vizë në Shqipëri “Raporti i 5 për regjimin e lirë vizave” nga Komisioni Evropian, shprehet se përtej rekordit pozitiv të Shqipërisë në adresimin e çështjeve të lidhura me migracionin, **u vu re se politika e vizave të Shqipërisë devijonte nga standardet**

⁶⁴ Neni 25 të ligjit Nr. 79 datë 18.10.2021 “Për të huajt”.

e BE-së duke lejuar udhëtime pa viza për shtetasit e disa vendeve të treta, si Armenia, Azerbajxhani dhe Turqia, shumica e të cilëve përballen me kërkesa për viza nga BE-ja. Për pasojë nga ky raport Shqipëria u këshillua të përputhte më ngushtë politikat e saj të vizave me rregulloret e BE-së për të shmangur rreziqet e mundshme të migracionit të parregullt dhe kërcënimeve të sigurisë.⁶⁵

Rasti *Ahorugeze kundër Suedisë*,⁶⁶ është një çështje e rëndësishme e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *që trajton refuzimin e një vizë* për një individ nga Suedia. Në këtë rast, Z. Ahorugeze, një shtetas i një vendi afrikan (Ruanda), kishte aplikuar për një vizë për të hyrë në Suedi dhe për të vizituar disa të afërm. Autoritetet suedeze refuzuan aplikimin e tij, duke argumentuar se ai nuk kishte paraqitur prova të mjaftueshme për qëllimin e udhëtimit dhe për mbulimin e shpenzimeve gjatë qëndrimit në Suedi. Ahorugeze e sfidoi këtë refuzim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke pretenduar se ky veprim kishte shkelur të drejtat e tij nën Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht të drejtën për respektimin e jetës familjare dhe të drejtën për një shqyrtim të drejtë.

Gjykata shqyrtoi nëse refuzimi i vizës përbente një shkelje të të drejtave të garantuara nga Konventa. Pas një analize të detajuar, GjEDNJ vendosi se Suedia nuk kishte shkelur të drejtat e kërkuarit. Gjykata theksoi se autoritetet suedeze kishin vepruar në përputhje me ligjet dhe praktikën e tyre dhe se kërkuari nuk kishte ofruar prova të mjaftueshme që të justifikonin refuzimin e vizës për të mbajtur lidhjet e tij familjare në Suedi.⁶⁷

Vendimi i Gjykatës u bë përfundimtar më 4 qershor 2012, duke konfirmuar se Suedia kishte vepruar brenda kufijve të ligjit në refuzimin e vizës dhe se nuk kishte shkelur të drejtat e kërkuarit. Ky rast ilustron rëndësinë e përputhshmërisë me procedurat kombëtare të vizave dhe shqyrtimin e ndjeshmërisë së ndikimit që mund të ketë një refuzim vizë në jetën private dhe familjare të individëve.⁶⁸

4.2 Procedurat për marrjen e lejes së qëndrimit dhe llojet e lejeve.

Referuar legjislacionit në fuqi, i huaji mund të qëndrojë në RSH për një periudhë afatshkurtër, për një periudhë të përkohshme, si dhe të përhershme. Qëndrimi për një periudhë afatshkurtër nuk mund të kalojë afatin 90 ditë për 180 ditë, në bazë të vizës së lëshuar apo hyrjes pa vizë, përjashtuar kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj ose në marrëveshje të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëndrimi për një periudhë të përkohshme dhe të përhershme mund të realizohet vetëm në përmjet pajisjes të të huajit me leje qëndrimi.

⁶⁵ Fifth report on EU visa-free regime Western Balkans Eastern Partnership countries, 2022 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=COM%3A2022%3A715%3AREV1&qid=1670337341649>

⁶⁶ *Case of Ahorugeze v. Sëden*, Application No. 37075/09, Judgment of 27 October 2011, final on 4 June 2012. <https://hudoc.echr.coe.int/?i=001-107183>

⁶⁷ *Po aty.*

⁶⁸ *Case of Ahorugeze v. Sëden*, Application No. 37075/09, Judgment of 27 October 2011, final on 4 June 2012. <https://hudoc.echr.coe.int/?i=001-107183>

Numri i aplikimeve për leje qëndrimi në Shqipëri, në vitin 2023 ishte 12.430 aplikime, duke shënuar një rritje me 22,7 %, krahasuar me vitin 2022. Aplikimet sipas vendit të origjinës nga Kosova dhe Italia përbëjnë 28,5 % të aplikimeve gjithsej në 2023. Vendet me numrin më të madh të aplikimeve janë Itali, Kosovë, Turqi, SHBA, Egjipt, Filipine, Maqedoni e Veriut, Bangladesh, Siri, dhe 5.342 nga shtete e tjera.⁶⁹

Leja e qëndrimit lëshohet sipas motiveve të mëposhtme⁷⁰:

- a) për motive të bashkimit familjar;
- b) për motive studimi (student dhe nxënës);
- c) për të trajnuarin pa pagesë;
- d) për *au pairs*;
- e) për shkëmbime rinore;
- f) për kërkim shkencor;
- g) për kërkimin e punës ose sipërmarrjen për kërkuesit shkencorë dhe studentët;
- h) për raste humanitare;
- i) për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore;
- j) për personat pa shtetësi;
- k) për leje unike qëndrimi për motive pune, si:
 - leje unike si punëmarrës;
 - leje unike për punësim stinor;
 - leje unike për të transferuar brenda ndërmarrjes;
 - leje unike si punëtor ndërkufitar;
 - leje unike për formim profesional;
 - leje unike për sportistë;
 - leje unike për shërbim vullnetar;
 - leje unike për punonjës me kualifikim të lartë;
 - leje unike për persona të vetëpunësuar;
 - leje unike për punonjës lëvizës digjital;
 - leje unike për investitorë;
 - leje unike për shërbime kontraktuese;
 - leje unike për kategori të veçanta.
- l) për ekuipazhin e mjeteve të lundrimit;
- m) për leje qëndrimit për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi;
- n) për leje qëndrimit për pensionistët.

Referuar ligjit për të huajt llojet e lejeve të qëndrimit kategorizohen si më poshtë:⁷¹

- a) leje qëndrimi e tipit “A”, e cila i jep të drejtën mbajtësit vetëm të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë brenda afatit kohor për të cilën ajo lëshohet;

⁶⁹ INSTAT, Të huajt në shqipëri 2023. <https://www.instat.gov.al/media/13789/publikimi-te-huajt-ne-shqiperi-2023-shqip.pdf>

⁷⁰ Shih neni 39 i Ligjit “Për të huaj”

⁷¹ Shih neni 32 i Ligjit “Për të huaj”

- b) leje qëndrimi ose leje unike e tipit “B”, e ripërtëritshme, e cila lëshohet me afat të përcaktuar dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë brenda afateve të përcaktuara në të;
- c) leje qëndrimi ose leje unike e tipit “C”, e cila lëshohet me afat të përhershëm dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë;
- d) leje qëndrimi unike “Kartë blu AL”, e ripërtëritshme, e cila lëshohet me afat të përcaktuar vetëm për punonjës me kualifikim të lartë dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë brenda afateve të përcaktuara në të;
- e) leje qëndrimi “Kartë blu AL-C”, e cila lëshohet me afat të përhershëm vetëm për punonjës me kualifikim të lartë dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë.

Leje qëndrimi e tipit "A": Kjo leje i jep të drejtën mbajtësit vetëm të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë të caktuar. Nuk i jep të drejtën të punojë ose të ketë akses në tregun e punës. Është një leje qëndrimi më e thjeshtë, e lëshuar për qëllime specifike siç është qëndrimi afatshkurtër për turizëm, trajtim mjekësor, etj.

Leje qëndrimi ose leje unike e tipit "B": Kjo leje është e ripërtëritshme dhe i jep mbajtësit të drejtën të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë nga Republika e Shqipërisë brenda një periudhe të caktuar. Mund të jetë e vlefshme për qëllime të ndryshme, përfshirë edhe për punësim, dhe është më fleksibile krahasuar me tipin "A".

Leje qëndrimi ose leje unike e tipit "C": Leje me afat të përhershëm, që i jep mbajtësit të drejtën të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë nga Republika e Shqipërisë në çdo kohë. Kjo leje u jepet individëve që kanë plotësuar kriteret për qëndrim të përhershëm, pas një periudhe të caktuar qëndrimi në vend.

Sipas ligjit nr. 79/2021 është parashikuar leja e qëndrimit unike “*Karta blu AL*” dhe “*Karta blu AL-C*”. Leja e qëndrimit “Karta blu AL” lëshohet me afat të përcaktuar vetëm për punonjës me kualifikim të lartë dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë brenda afateve të përcaktuara në të. Kjo leje lëshohet për një afat 2-vjeçar dhe mund të ripërtërihet për një periudhë 3-vjeçare. Ndërkohë leja e qëndrimit “Kartë blu AL-C”, e cila lëshohet me afat të përhershëm vetëm për punonjës me kualifikim të lartë. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis të huajin me leje unike “Kartë blu AL” për punë me kualifikim të lartë vetëm nëse ka marrë më parë miratimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për punonjës të kualifikuar dhe kur përmbush kushtet për marrjen e një lejeje qëndrimi “Kartë blu AL”.

Ligji nr. 79/2021 “*Për të huajt*” ndër risit që solli ishte kombinon lejen e qëndrimit dhe të punës në një dokument të vetëm, duke e bërë procesin më të thjeshtë dhe më të shpejtë për të huajt që duan të punojnë dhe jetojnë në Shqipëri. Kjo risi synonte reduktimin e burokracisë dhe kohën e përpunimit për marrjen e lejeve.

Të gjitha kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për pajisje me leje qëndrimi është i përcaktuar në VKM Nr. 858 datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë” e ndryshuar.⁷²

V. Procedurat për të përfutur mbrojtjen ndërkombëtare dhe statusin e refugjatit

Republika e Shqipërisë garanton të drejtën për azil të shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, i cili ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi për shkak të:

1. frikës së bazuar për të qenë i persekutuar
2. për arsye të racës,
3. të besimit fetar,
4. të kombësisë,
5. të anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose të bindjes politike.⁷³

Referuar ligjit Nr. 10 datë 24.02.2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” (këtu dhe në vijim “**Ligji Për Azilin**”) “Azil” është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve dhe personave në mbrojtje plotësuese. Ndërsa “Azilkërkues” është çdo shtetas i huaj ose person pa shtetësi, që ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, për të cilën nuk është marrë ende një vendim përfundimtar i formës së prerë.

Kryesisht Shqipëria ashtu si dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria ka qenë vend tranzit për emigrantët dhe refugjatët dhe jo destinacion. Megjithatë, autoritetet shqiptare kanë bërë përpjekje në përgjigje të flukseve të tilla migratore për të ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme dhe për një reagim efikas ndaj azilkërkuesve dhe për mbrojtjen e refugjatëve. Ndërsa vitete fundit vihet re se në shqipëri ka patur rritje të numrit të azilkërkuesve.

Referuar Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në vitin 2023, rezultojnë 261 azilkërkues, duke shënuar një rritje, krahasuar me një vit më parë, ku kishim 125 azilkërkues. Azilkërkuesit me origjinë nga Afganistani zënë 61,7 % të azilkërkuesve gjithsej dhe rezultojnë 161 persona.⁷⁴

Ndër parimet kryesore ku bazohet ky ligj, diktuar dhe nga Konventa e Gjenevës, vlen të përmendet parimi i moskthimit, ndërkohë që respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara dhe nga konventat e tjera ndërkombëtare, ndalimi i dëbimit, e drejta për lirinë nga tortura dhe trajtimi mizor, çnjerëzor dhe degradues, e drejta e procedurave dhe garancive ligjore për ndihmën juridike falas nga shteti, e drejta për kushtet minimale të jetesës, për kujdes

⁷² <https://qbz.gov.al/share/09E93V77RY2YpX3Fe7eWmg>

⁷³ Neni 5 i ligjit Nr. 10 datë 24.02.2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

⁷⁴ Azilkërkuesit në Shqipëri 2023, INSTAT <https://www.instat.gov.al/media/13767/azilkerkuesit-dt-03072024.pdf>

shëndetësor, për arsimim, për punësim dhe trajnime profesionale, e drejta për bashkim familjar, për të pasur një përkthyes, apo dhe e drejta e ankimit, mbeten kryefjala e këtij ligji.

Parimi i moskthimit është një nga parimet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare, i cili vepron kryesisht në fushën e të drejtave të njeriut, duke i dhënë atyre aktualisht një dimension të ri. Ky parim i ndalon shtetet që të kthejnë mbrapa, dëbojnë ose ekstradojnë një person të caktuar, në territoret e shteteve ku ka dyshime të bazuara se atij i kërcënohet seriozisht jeta ose liria, për shkak të racës, besimit, kombësisë anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose për shkak të bindjeve politike të tij.

Në nenin 33 paragrafi i parë i Konventës së Refugjatëve të vitit 1951 përcaktohet se “Palët Kontraktuese nuk do të dëbojnë një refugjat që ndodhet ligjërisht në territorin e tyre, përveç në rastin kur cenohet sigurimi kombëtarë ose rendi publik.” Pra ky nen nuk e mbron refugjatin nga kthimi nëse ka arsye të besueshme se refugjati përbën rrezik për vendin në të cilin ai ose ajo është, ose i cili ka qenë dënuar me vendim gjykatë për kryerjen e një krimi që përbën rrezik për komunitetin e atij vendi⁴¹. Nga interpretimi i këtij neni vërejmë që parimi moskthimit në nenin 33 të Konventës kufizohet nga 2 arsye të cilat janë:

1. Cenimi i sigurisë kombëtare ose rendit publik;
2. Bindja nga gjykata se përbën rrezik për komunitetin.

Këto kufizime i gjejnë të sanksionuara në paragrafin e dytë të nenit 33 të Konventës dhe do të trajtojmë më gjerësisht në vijim.

5.1 Procedura për Shqyrtimin e Kërkesës për Mbrojtje Ndërkombëtare (Azil) dhe Statusi i Refugjatit

Sipas legjislationit në fuqi shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi (këtu dhe në vijim “**Azilkërkuuesi**”) mund të shprehë qëllimin për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, verbalisht ose në formë të shkruar, në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, në një pikë të kalimit kufitar, në një stacion të Policisë së Shtetit, pranë autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin. Autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin është autoriteti shtetëror përgjegjës për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes dhe regjistrimit të shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, që ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në pikat e kalimit kufitar ose brenda territorit të RSH.⁷⁵

Mbrojtja ndërkombëtare i referohet dy formave:⁷⁶

1. “**Mbrojtja plotësuese**” është formë mbrojtjeje që i jepet shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, që nuk i përmbush kriteret për të fituar statusin e refugjatit dhe ka arsye serioze e të bazuara të mendohet se në rast të kthimit të tij në vendin e origjinës apo në rastin e personit pa shtetësi në vendbanimin e tij të zakonshëm të mëparshëm, ai

⁷⁵ Urdhër Nr. 247, datë 3.6.2021 “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave të dërgimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare nga Autoriteti Përgjegjës për Kufirin dhe Migracionin tek Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët” https://qbz.gov.al/share/gzkV9_QqTDK7-3tTMëk1në

⁷⁶ Neni 5 pika 19 dhe 20 e ligjit Nr. 10 datë 24.02.2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

rrezikon realisht të përballet me cenime të rënda dhe nuk ka mundësi, apo për shkak të rrezikut të tillë nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi.

2. **“Mbrojtje e përkohshme”** është një procedurë e veçantë mbrojtjeje, e cila u siguron mbrojtje të menjëhershme dhe të përkohshme personave të shpërngulur në rastet e flukseve masive, të cilët nuk mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës, në veçanti, nëse ekziston rreziku që sistemi i azilit të jetë i paaftë të procedojë me këtë fluks, pa krijuar efekte të pafavorshme në funksionimin e tij efektiv, në interes të këtyre personave.

Azilkërkuesi, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, informohet për procedurën për përcaktimin e statusit të mbrojtjes, të drejtat dhe detyrimet në një procedurë të tillë, kushtet e pritjes, të drejtën për të kontaktuar me përfaqësues të UNHCR-së në çdo fazë të procedurës, me pasojat e mundshme në rast të mos përmbushjes së detyrimeve dhe mosbashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse si dhe të drejtën për ndihmë ligjore. Ky informacion jepet në mënyrë verbale dhe, nëse është e nevojshme, sigurohet edhe në formë të shkruar, gjithmonë në gjuhën që azilkërkuesi kupton.

Në kohën e plotësimit të formularit të përcaktimit të statusit për mbrojtje ndërkombëtare, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët informon kërkuesin dhe me pëlqimin e tij mundëson kontaktin me një specialist në çështjet e azilit, për shërbime ligjore falas. Ky i fundit me shpenzimet e tij ka të drejtë të zgjedhë një përfaqësues, i cili do ta ndihmojë dhe do ta përfaqësojë atë gjatë procedurës për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare.

Përfaqësuesi i autorizuar ka të drejtë të njihet me informacionin në dosjen e Azilkërkuesit, por mund t'i mohohet aksesin në dosjen e kërkuesit, kur zbulimi i informatave ose burimeve rrezikon sigurinë kombëtare, sigurinë e organizatave apo personave që ofrojnë informacionin, sigurinë e personit të cilit i referohet informacioni, kur cenohen interesat e hetimit në lidhje me shqyrtimin e kërkesës nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët ose rrezikohen marrëdhëniet ndërkombëtare të RSH. Përrjashtimisht, në këto raste informacioni mund t'i lejohet një përfaqësuesi ligjor i cili është i pajisur me certifikatë të sigurisë për njohjen e informacionit të klasifikuar

Gjatë kësaj periudhe deri në dhënien e vendimit përfundimtar ose të formës së prerë nga gjykata, kërkuesi lejohet të Azilkërkuesi ka të drejtë të qëndrojë në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkues brenda territorit të RSH dhe nuk mund të kërkojë leje qëndrimi me motiv tjetër në bazë të ligjit për të huajt. Nëse azilkërkuesit i është refuzuar aplikimi për azil, i lejohet të qëndroje në territor apo të akomodohet në qendër derisa të mbarojnë procedurat e ankimimit apo afatet për ushtrimin e tyre.

Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët fillon procedurën e intervistimit të azilkërkuesit brenda një kohe sa më të shkurtër që të jetë e mundur nga paraqitja e kërkesës ku i garantohet konfidencialiteti. Azilkërkuesi intervistohet personalisht pa praninë e anëtarëve të familjes, përveç rastit kur struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët e konsideron të nevojshme praninë e tyre për të zhvilluar shqyrtimin e duhur të kërkesës.

Procedura për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare nis sapo personi që kërkon mbrojtje plotëson formularin për përcaktimin e statusit të mbrojtjes pranë autoritetit përgjegjës. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët vlerësojnë nëse kërkuesi plotëson kushtet për të marrë statusin e refugjatit ose mbrojtje plotësuese, duke i dhënë mundësinë të dorëzojë dhe shpjegojë të gjitha provat dhe dokumentet që lidhen me kërkesën e tij.

Azilkërkuesi ka për detyrë të paraqesë sa më shpejt të gjitha dokumentet e nevojshme që lidhen me moshën, identitetin, kombësinë, historinë e udhëtimeve dhe arsyet që e kanë detyruar të kërkojë mbrojtje ndërkombëtare. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, autoritetet marrin në konsideratë informacione nga burime ndërkombëtare, si EASO dhe UNHCR, për situatën në vendin e origjinës së kërkuesit dhe vendet e tranzitit.

Deklaratat e azilkërkuesit vlerësohen së bashku me dokumentet e paraqitura dhe situatën personale të tij, si orientimi seksual apo mosha, për të vlerësuar nëse është persekutuar për këto arsye. Nëse kërkuesi nuk mund të sigurojë dokumente mbështetëse, deklarata e tij mund të konsiderohet e besueshme, me kusht që të ketë bërë përpjekje të sinqerta për të justifikuar kërkesën dhe informacioni i dhënë të jetë koherent dhe në përputhje me faktet.

Në disa raste, autoritetet mund të kërkojnë dëshmi shtesë për të marrë vendimin përfundimtar për kërkesën e mbrojtjes ndërkombëtare.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të vendosë me një vendim të ndërmjetëm ndërprerjen e procedurës për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare në rastet kur:

- a) kur kërkuesi tërheq kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare;
- b) kur kërkuesi largohet nga vendqëndrimi i fundit për më shumë se 3 (tri) ditë pa njoftuar autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët, përveç rasteve kur kërkuesi vërteton brenda një kohe të arsyeshme se largimi i tij dhe moslajmërimi kanë ndodhur “për shkaqe të justifikueshme” ose “për shkaqe që nuk varen prej tij”;
- c) nuk është paraqitur në intervistë në datën e komunikuar për zhvillimin e intervistës dhe nuk ka njoftuar autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët për arsyet e mosparaqitjes, brenda 3 (tri) ditëve;
- d) është larguar nga Republika e Shqipërisë gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës, pa dijeninë e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

Procedura për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatet zgjat 6- muaj nga data e paraqitjes së kërkesës. Për raste të veçanta të parashikuara në ligj ky afat mund të zgjatet për një periudhë shtesë prej 3- muajsh por në çdo rast Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët përfundon shqyrtimin brenda afatit maksimal kohor prej 21 muajsh nga paraqitja e kërkesës.

Në përfundim të procedurës së shqyrtimit të kërkesës, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët merr vendim nëpërmjet të cilit:

- a) njeh statusin e refugjatit;
- b) refuzon statusin e refugjatit dhe njeh statusin e mbrojtjes plotësuese;

- c) refuzon kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare;
- d) ndërpret procedurën për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare;
- e) pushon shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

Vendimi i autoritetit përgjegjës në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët merret në një mbledhje të posaçme me shumicë votash. Vendimi përpilohet me shkrim dhe arsyetohet. Në rastin kur punonjësit e autoritetit përgjegjës në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët, të cilët janë në pakicë, mund ta shprehin me shkrim mendimin e tyre kundër, i cili i bashkëlidhet vendimit përfundimtar. Një kopje e vendimit të autoritetit përgjegjës në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët i komunikohet kërkuarit dhe UNHCR-së brenda 5 ditëve nga data e marrjes të vendimit.

Në raste të përligjura autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të marrë vendim për zbatimin e procedurës së përsheptuar, në përputhje me parimet dhe garancitë themelore.

Një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare mund të konsiderohet e papranueshme nëse azilkërkuari tashmë ka marrë mbrojtje nga një shtet anëtar i BE-së ose një shtet tjetër i sigurt, ose nëse kërkesa është përsëritur pa informacione të reja. Autoriteti që shqyrton kërkesën siguron që azilkërkuari të informohet për konceptin e "shtetit të sigurt të origjinës" dhe t'i jepet mundësia të kundërshtojë vendimin. Nëse një vend i tretë nuk lejon hyrjen e kërkuarit, autoriteti përgjegjës siguron qasje në procedurën e azilit.

Kërkesat mund të refuzohen nëse ato janë dukshëm të pabazuara, që do të thotë se nuk përmbajnë ndonjë lidhje me kriteret për mbrojtje ndërkombëtare, ose kërkuari ka dhënë informacione të rreme ose ka hyrë në Shqipëri në mënyrë të paligjshme dhe nuk është paraqitur brenda një afati prej 10 ditësh. Kërkesat refuzohen gjithashtu nëse kërkuari përbën rrezik për sigurinë kombëtare ose rendin publik.

Kërkesa e re për mbrojtje mund të paraqitet nëse ka fakte dhe të dhëna të reja që mund të ndikojnë në kualifikimin për mbrojtje ndërkombëtare, dhe nëse konstatohen, ajo do të shqyrtohet sipas procedurës së rregullt.

Azilkërkuari, i cili deklaron qëllimin për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, transferohet në Qendrën e Pritjes për Azil, ku ka të drejtë të qëndrojë deri në momentin kur merret vendimi përfundimtar.⁷⁷

Sipas VKM Nr. 630 , datë 27.10.2021 "*Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Pritjes për Azil*"⁷⁸, Qendra e Pritjes për Azil (QPA) ka këto përgjegjësi:

- a) organizon punën për të siguruar pranimin kolektiv të kërkuarëve për mbrojtjendërkombëtare;

⁷⁷ Shih neni 43 i Ligjit për Azilin

⁷⁸ VKM Nr. 630 , datë 27.10.2021 "*Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Pritjes për Azil*"
<https://qbz.gov.al/share/bxigSAjLRKK7p3RdXh0WDg>

- b) organizon punën për të siguruar ofrimin e standardeve të jetesës së përshtatshme përkërkuesit e mbrojtjes ndërkombëtare;
- c) organizon punën për të siguruar zhvillimin e programeve pedagogjike e edukuese dhe këshillimin ligjor falas për kërkuesit e mbrojtjes ndërkombëtare.

- **Mbrojtja e përkohshme ndërkombëtare**

Sa i përket mbrojtjes së përkohshme në Shqipëri u ofrohet shtetasve të huaj ose personave pa shtetësi që vijnë në mënyrë masive nga një vend, ku për arsye të luftës ose situatës së ngjashme, të dhunës së përgjithshme ose konfliktit të brendshëm, të karakterizuara nga shkelje të të drejtave të njeriut, kur shteti, nga i cili kanë ardhur, nuk mund të garantojë mbrojtjen e tyre. Ajo jepet për një periudhë 1-vjeçare me vendim të Këshillit të Ministrave, duke pasur parasysh kushtet ekonomike dhe sigurinë kombëtare, dhe mund të zgjatet deri në 3 vjet nëse vazhdojnë kushtet në vendin nga kanë ardhur personat e mbrojtur, të cilat përbënin bazën e vendimit për dhënien e mbrojtjes. Personat që përfitojnë nga kjo mbrojtje kanë të drejtë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare (azil) gjatë kësaj periudhe. Përjashtime nga mbrojtja bëhet për rastet kur personit për të cilin ka arsye serioze të konsiderohet se:

- a) ka kryer krim kundër paqes, krim lufte ose krim kundër njerëzimit, të përcaktuara në instrumentet ndërkombëtare të hartuara për krime të tilla;
- b) ka kryer një krim të rëndë jopolitik jashtë Republikës së Shqipërisë para pranimit të tij si person që gëzon mbrojtje të përkohshme. Ky përcaktim zbatohet edhe për pjesëmarrësit në krim dhe/ose për nxitësit e tij;
- c) është shpallur fajtor për akte që janë në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara;
- d) paraqet rrezik për sigurinë kombëtare dhe rendin publik të RSH.

Mbrojtja e përkohshme përfundon në rastet kur kalon afati i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, kur nuk ekzistojnë më arsyet për të, kur i huaji largohet nga Shqipëria, kur i jepet një lloj tjetër mbrojtjeje ose kur i huaji dëbohet. Për kthimin e personave, autoritetet përgjegjëse mundësojnë kthimin vullnetar, duke respektuar dinjitetin e tyre. Ndërsa në rastet e kthimit me forcë, merren parasysh faktorë humanitarë. Gjithashtu, autoriteti përgjegjës kujdeset për personat që nuk mund të udhëtojnë për arsye shëndetësore, duke mos i dëbuar deri në përmirësimin e gjendjes. Kërkesat për kthim vullnetar vlerësohen bazuar në situatën në vendin e origjinës.

Personat që përfitojnë mbrojtjen e përkohshme kanë të drejtë:⁷⁹

- a) të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë sipas kohëzgjatjes së mbrojtjes së përkohshme;
- b) të kenë kushtet themelore të jetesës dhe të strehimit, në përputhje me mundësitë ekonomike të Republikës së Shqipërisë;
- c) të përfitojnë kujdes shëndetësor;
- d) për arsim parauniversitar në të njëjtat kushte me shtetasit shqiptarë;

⁷⁹ Per me teper shih Ligjin “Për Azilin”

- e) për ushtrimin e mendimit, besimit fetar dhe lirinë e fesë sipas bindjeve të tyre, në përputhje me parashikimet e legjisllacionit përkatës në fuqi;
- f) për punë dhe trajnime profesionale;
- g) për ndihmë juridike të garantuar nga shteti.

Përrjashtimisht, një i huaj nën mbrojtje të përkohshme gëzon të drejtën për të kërkuar bashkim familjar vetëm nëse kjo e drejtë nuk mund të realizohet në asnjë vend tjetër, përveçse në territorin e RSH.

5.1.1 Pushimi, shfuqizimi, humbja e mbrojtjes ndërkombëtare

Statusi i refugjatit mund të humbet kur personi vendos vullnetarisht të kthehet në vendin e origjinës, fiton shtetësi të re dhe gëzon mbrojtje nga shteti i ri, ose nëse rrethanat që e bënë të nevojshme mbrojtjen ndërkombëtare ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme dhe të qëndrueshme. Gjithashtu, humbet statusin nëse largohet nga territori i Shqipërisë pa njoftuar autoritetet përkatëse.⁸⁰

Statusi mund të shfuqizohet nëse është bazuar në informacione të rreme, personi përbën kërcënim për sigurinë kombëtare, apo është dënuar për krime të rënda që cenojnë rendin publik. Përpara marrjes së vendimit për shfuqizim, personi njoftohet dhe i jepet mundësia për të paraqitur pretendimet e tij.

Statusi i mbrojtjes plotësuese pushon kur rrethanat që e justifikonin atë ndryshojnë në mënyrë të qëndrueshme ose kur personi heq dorë vullnetarisht nga mbrojtja ose largohet nga Shqipëria pa njoftuar autoritetet. Nëse këto rrethana janë të përkohshme ose personi mund të paraqesë arsye bindëse që rrjedhin nga përndjekjet e mëparshme, statusi i mbrojtjes plotësuese mund të mos pushojë. Statusi gjithashtu mund të shfuqizohet për shkak të mashtrimit, rrezikut për sigurinë kombëtare, ose përjashtimeve të tjera sipas ligjit.

- ***A mundet që një person pa shtetësi të jetë dhe refugjat?***

Pashtetësia nuk përbën persekutim nën përkufizimin e refugjatit të përcaktuar në Konventën për Refugjatit e vitit 1951, por ajo mund të jetë një element i persekutimit të marrë në mënyrë të përmbledhur me faktorë të tjerë. Heqja arbitrare e shtetësisë mbi baza diskriminuese mund të krijojë shkaqe për një frikë të bazuar mbi persekutimin, veçanërisht kur rezultojnë në pashtetësi. Konventa e Gjenevës 1951 garanton të drejtat e refugjatëve, duke përfshirë dhe ata që janë pa shtetësi, ndërkohë që Konventa e vitit 1954 është projektuar për personat pa shtetësi, të cilët nuk janë refugjatë. Në rastet kur një person kualifikohet për të dy statuset, prevalon Konventa e Refugjatit të vitit 1954.

⁸⁰ Neni 39 i Ligjit “Për Azilin”

5.1.2 Persona që i përkasin kategorisë së veçantë dhe fëmijët e pashoqëruar

Persona që i përkasin kategorisë së veçantë janë fëmijët, fëmijët e pashoqëruar, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar, gratë shtatzëna, prind i vetëm me fëmijë të mitur, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, viktimat e gjymtimit gjenital, LGBTI, personat me sëmundje të rënda, personat me probleme/çrregullime të shëndetit mendor ose personat, të cilët kanë qenë subjekt i torturës, përdhunimit apo ndonjë forme tjetër të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale.

Në përputhje me ligjin për azilin dhe refugjatët, personat që i përkasin kategorisë së veçantë trajtohen me vëmendje dhe kujdes të veçantë nga autoritetet përgjegjëse. Ky ligj siguron që këta individë, të cilët mund të jenë kërkues, refugjatë, persona nën mbrojtje plotësuese ose përkohshme, të marrin trajtimin e nevojshëm në përputhje me nevojat e tyre të veçanta.

Nevojat e këtyre individëve përcaktohen nëpërmjet vlerësimit individual të çdo kërkuesi. Pjesëtarët e kësaj kategorie përfitojnë një trajtim të ndryshëm që përfshin akomodimin e përshtatshëm, kushte të veçanta pranimi, trajtim mjekësor dhe këshillim psikosocial të nevojshëm. Për ata që kanë përjetuar torturë, përdhunim, ose forma të tjera të dhunës së rëndë, ligji parashikon një trajtim të plotë dhe të duhur për dëmet e shkaktuara, duke përfshirë mundësinë për trajtim mjekësor dhe psikologjik të nevojshëm.

Personat që punojnë me viktimat e dhunës duhet të kenë marrë trajnimin e duhur dhe të respektojnë rregullat e konfidencialitetit për informacionin që mblidhet gjatë punës së tyre.

Në lidhje me procedurat e veçanta dhe garancitë e pranimit, kërkuesit përfitojnë mbështetje në përputhje me rrethanat e tyre personale, si moshë, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, aftësitë e kufizuara, sëmundjet e rënda, çrregullimet mendore, ose si rezultat i torturës dhe dhunës të tjera të rëndë. Këto procedura mbikëqyren vazhdimisht nga punonjës të trajnuar posaçërisht, që nga momenti i shprehjes së qëllimit për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Në raste të caktuara, si për viktimat e torturës dhe dhunës së rëndë, procedura e përshpejtuar nuk zbatohet nëse nuk sigurohet mbështetje e duhur. Për kërkuesit me probleme të shëndetit mendor, caktohet një përfaqësues që do t'i ndihmojë gjatë procedurës për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

Në Shqipëri në mënyrë të veçantë trajtohen edhe *fëmijët e pashoqëruar*⁸¹ që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare është i rregulluar me kujdes për të siguruar mbrojtjen e duhur të të drejtave të tyre. Ligji për Azilin parashikon se kur një fëmijë i pashoqëruar shpreh qëllimin për mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri, ai merr mbrojtje dhe caktohet një kujdestar në përputhje me ligjin. Autoritetet për kufirin dhe migracionin njoftojnë menjëherë strukturën e shërbimeve shoqërore në bashki. Brenda pesë ditëve nga vendimi për mbrojtje, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës

⁸¹ Shi neni neni 52 i Ligjit “Për azilin”

depoziton kërkesën në gjykatë për të certifikuar masën emergjente të mbrojtjes ose masën e mbrojtjes për përkujdesjen alternative dhe për kujdestari.

Fëmijët e pashoqëruar nuk mund të intervistohen pa qenë të shoqëruar nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, i cili vepron në interesin më të lartë të fëmijës dhe mund të ndryshohet vetëm nëse është e nevojshme. Kujdestari informon fëmijën për kuptimin dhe pasojat e mundshme të intervistës dhe, kur është e nevojshme, si të përgatitet për të.

Kur një fëmijë i pashoqëruar intervistohet për mbrojtje ndërkombëtare, intervista zhvillohet nga një nëpunës që ka njohuri për nevojat e veçanta të fëmijës. Autoritetet për azilin dhe refugjatët bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të gjetur prindërit ose të afërmit e fëmijës dhe koordinon vendosjen e fëmijës në një ambient të përshtatshëm, qoftë me të afërmit e rritur, një familje kujdestare, në qendra të specializuara për fëmijët, ose në akomodim tjetër të përshtatshëm.

Në raste kur ka kërcënime për jetën ose integritetin e fëmijës, informacioni për ata persona duhet të mbledhet dhe të përpunohet në mënyrë konfidenciale. Për atë që është e mundur, vëllezërit dhe motrat mbahen së bashku duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijëve dhe ndryshimet e vendqëndrimit kufizohen sa më shumë të jetë e mundur.

Për sa i përket vizitave mjekësore, fëmijët e pashoqëruar mund të nënshtrohen një vizite për të përcaktuar moshën e tyre nëse ka dyshime. Vizita kryhet me respekt për dinjitetin e fëmijës dhe nga profesionistë të kualifikuar, dhe rezultatet e saj shqyrtohen nga autoritetet për azilin dhe refugjatët. Në rastet e vizitës, fëmija duhet të informohet në një gjuhë që kupton dhe të japë pëlqimin për vizitën, dhe refuzimi i vizitës nuk ndalon shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje.

Trajtimi dhe mbrojtja e fëmijëve të pashoqëruar janë çështje të ndjeshme që kërkojnë vëmendje të veçantë nga autoritetet dhe organizatat ndërkombëtare.

Çfarë konsiderohen si sfida për trajtimin e kësaj kategorie i referohen kryesisht problematikave si me poshtë:

- **Kujdestaria dhe Akomodimi:** Fëmijët e pashoqëruar duhet të caktohet një kujdestar i cili është përgjegjës për mirëqenien e tyre. Ky kujdestar duhet të sigurojë që fëmija të ketë akses në shërbime të nevojshme dhe të jetë mbrojtur nga rreziqe të mundshme. Fëmijët e pashoqëruar duhet të vendosen në akomodime që janë të përshtatshme për nevojat e tyre dhe që ofrojnë një ambient të sigurt dhe mbështetje.⁸²
- **Trajtimi Psikologjik:** Fëmijët e pashoqëruar shpesh përballen me trauma dhe stres të rëndë për shkak të përvojave të tyre gjatë udhëtimit dhe gjatë periudhës së qëndrimit në vendin pritës. Ata kanë nevojë për mbështetje psikologjike dhe shërbime të tjera për të adresuar dëmet emocionale dhe psikologjike.⁸³

⁸² *Guidelines on Determining the Best Interests of the Child*, UNHCR pg. 61

<https://www.unhcr.org/media/unhcr-guidelines-determining-best-interests-child>.

⁸³ *Child Protection and Migration Report 2023*, UNICEF - Report.

<https://www.unicef.org/documents/inclusion-children-context-migration-national-child-protection-systems-0>

- **Procedurat Ligjore:** Fëmijët e pashoqëruar duhet të kenë akses në ndihmë ligjore dhe përfaqësim të përshtatshëm gjatë procedurave për kërkesat e azilit ose mbrojtjes ndërkombëtare. Procedurat duhet të jenë të dizajnuara për të mbrojtur interesat e fëmijës dhe për të siguruar që ata të marrin informacionin dhe mbështetje të nevojshme e ndërkombëtare.

Të gjithë ata që punojnë me fëmijë të pashoqëruar duhet të kenë trajnim të përshtatshëm dhe të respektojnë konfidencialitetin në lidhje me informacionin që marrin.

VI. Qasja e të huajve në Shërbime publike

6.1 Arsimimi dhe Shërbimet Sociale: Qasja e të huajve në arsim dhe shërbime shëndetësore

Sipas ligjit për të huajt në Republikën e Shqipërisë i huaji gëzon të drejtën për kujdes shëndetësor. Gjithashtu në nenin 133 të këtij ligji parashikohet se edhe të huajve të cilët nuk janë të pajisur me një dokument të vlefshëm udhëtimi, vizë ose leje qëndrimi të vlefshme dhe që nuk vërtetojnë që kanë hyrë dhe qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territor spitalet dhe qendrat shëndetësore u ofrojnë shërbim mjekësor në situata të emergjencave mjekësore. Theksojmë se një ndër kushtet për përfitimin e vizës dhe të lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë është edhe policë të sigurimit shëndetësor.

Bazuar në ligjin Nr.10 107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se shërbimi i kujdesit shëndetësor, që ofrohet në institucionet e kujdesit shëndetësor për shtetasit e huaj, që banojnë në Republikën e Shqipërisë, bëhet në bazë të marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare ose në bazë të parimit të reciprocitetit.

Në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare apo të kushteve ku zbatohet parimi i reciprocitetit, shtetasit e huaj përfitojnë shërbimet e kujdesit shëndetësor, në bazë të ligjit.

Shtetasit e huaj, që kanë nevojë për kujdes shëndetësor, në kushtet e urgjencës mjekësore, marrin kujdes shëndetësor dhe në kushte të barabarta me ato që zbatohen për shtetasit e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu sipas ligjit nr. 147/2014 "Për shërbimin e urgjencës mjekësore" shërbimi i urgjencës mjekësore në të gjitha nivelet e tij, për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj me banim të përhershëm ose të përkohshëm në Shqipëri, si dhe për çdo shtetas të huaj që është duke kaluar në territorin e Shqipërisë.

6.1.1 Aksesi i të huajve në sistemin arsimor.

Sipas ligjit për të huajt parashikohet se i huaji, i cili ka hyrë dhe qëndron në Republikën e Shqipërisë për qëllime studimi, pranë një institucioni arsimor publik apo privat të njohur nga shteti shqiptar, ka të drejtë të aplikojë për leje qëndrimi. I huaji, i pranuar në një institucion arsimor, apo që merr pjesë në trajnime ose praktika profesionale, pajiset me leje qëndrimi, me afat jo më shumë se një vit, kur lëshohet për herë të parë dhe mund të shtyhet çdo herë me një

vit deri në përfundimin e shkollës, të studimeve ose të praktikës. Në rast se kohëzgjatja e kursit është më e vogël se një vit, afati i lejes së qëndrimit është i barabartë me kohëzgjatjen e kursit.

Në mënyrë që të përfitoje lejen e qëndrimit i huaji duhet të provojë se është pranuar nga institucioni arsimor, se ka njohuri të mjaftueshme të gjuhës së shkollimit ose trajnimit, si dhe disponon mjete financiare të mjaftueshme për jetesën në Republikën e Shqipërisë gjatë studimeve.

Bazuar në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar përcaktohet dokumentacioni shtesë që duhet të paraqitet për vizë për motive studimi (student dhe nxënës) D/ST:

- a) Dokumenti, që vërteton pranimin në një institucion arsimor shqiptar;
- b) Dëshmia financiare, që vërteton mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe të shkollimit;
- c) Certifikata që provon njohjen e gjuhës, me të cilën kërkuesi i vizës do të kryejë studimet. Prova e njohjes së gjuhës mund të verifikohet edhe me intervistë nga i ngarkuari me çështjet konsullore në ambasadë ose konsullatë.

Dokumentacioni shtesë për pajisjen me leje qëndrimi për motive studimi (student dhe nxënës):

- Dokumenti i pranimit nga një institucion arsimor në Shqipëri;
- Dëshmia e burimeve të mjaftueshme financiare për jetesë gjatë qëndrimit në Shqipëri për periudhën e kërkuar;
- Dëshmia e njohjes së gjuhës të programit të studimit/gjuhës së zhvillimit të procesit mësimor apo vërtetim për pranimin në kursin përgatitor të gjuhës;
- Dokument se janë paguar tarifat e vendosura nga institucioni i arsimit të lartë.

Dokumente shtesë për nxënës:

- Dëshmi se nuk është nën moshën ose nën klasën minimale dhe as mbi moshën ose klasën maksimale të përcaktuar nga legjislacioni kombëtar;
- Dëshmi se nxënësi i huaj do të akomodohet nga një familje gjatë gjithë qëndrimit të tij në një ambient të veçantë akomodimi brenda institucionit arsimor ose në ndonjë ambient tjetër që përmbush kushtet e duhura.

Një ndër procedurat që të huajt duhet të kryejnë me qëllim ndjekjen e shkollimit ose studimeve në Republikë e Shqipërisë lidhet me njohjen e dëftesave, diplomave ose viteve të studimit.

Udhëzimi nr. 13, datë 30.6.2023 i ministrit të Arsimit dhe Sportit, i ndryshuar përcakton përcaktimin e kriteret dhe të procedurat të njëvlershmërisë së dëftesave dhe të diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit.

Aplikimi për njohjen dhe njësimin e dëftesës së përfundimit të arsimit bazë, dëftesave të klasave, si dhe diplomës së arsimit të mesëm të lartë, që i përkasin nivelit 1 deri në 4 të Kornizës

Shqiptare dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, kryhet *online* nëpërmjet portalit *e-Albania* në shërbimin elektronik "*Aplikim për njëvlefshmërinë e dëftesave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit*".

Procedura e njohjes dhe njësimit të dëftesës së përfundimit të arsimit bazë dhe të dëftesave të klasave të arsimit parauniversitar, pas aplikimit *online* vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga ana e Komisionit të Njohjes së Dëftesave në ZVAP. Kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, kjo procedurë përfundon brenda 45 ditëve.

Procedura e njohjes dhe njësimit e diplomës së shkollës së mesme, që i përket nivelit 4 të Kornizës Shqiptare dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, pas aplikimit *online*, vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga ana e Komisionit të Njohjes së Diplomave në QSHA. Kjo procedurë, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, përfundon brenda 45 ditëve.

Lidhur me ndjekjen e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë kuota të veçanta për studentet e huaj në programet e studimit që ofrojnë.

Të huajt mund të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas afateve të përcaktuara nga këto institucione për çdo vit akademik, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat për këto kategori nga IAL-të në programet e studimit që ato ofrojnë.⁸⁴ Në udhëzimin e Ministrisë të Arsimit dhe Sportit është parashikuar se regjistrimi i këtyre kandidatëve fitues bëhet me rezervë, nëse në momentin e regjistrimit nuk zotërojnë dokumentin e njohjes dhe njësimit të lëshuar nga QSHA-ja. Një parashikim i tillë ju mundëson të huajve të regjistrohen me rezerve në kushtet kur nuk e kanë përfunduar akoma njohjen e diplomës që përbën kusht për ndjekjen e studimeve.

Të huajt duhet të paraqesin në institucionin e arsimit të lartë edhe dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe). Në rastet kur të huajt kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i studimit të IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i paraqitjes së dëshmisë së njohjes së kësaj gjuhe të huaj.

6.1.2 Qasja e refugjatëve në arsim si një kategori veçantë e të huajve.

Arsimi është një ndër të drejtat themelore të gjithësecilit, prandaj të gjithë personave pavarësisht rrethanave në të cilat ndodhën duhet t'u sigurohet aksesin në sistemin arsimor.

⁸⁴ Kreu VI i udhëzimit nr. 12, datë 30.6.2023 i ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë".

Bazuar në Konventën e Gjenevës "Për statusin e refugjatit"⁸⁵, parashikohet se shtetet palë duhet t'u japin refugjatëve të njëjtin trajtim që u japin shtetasve të tyre në lidhje me arsimin bazë. Lidhur me nivelet arsimore të ndryshme nga arsimi bazë, shtetet palë duhet t'u japin refugjatëve një trajtim sa më të favorshëm të jetë e mundur, dhe në çdo rast, jo më pak të favorshëm se trajtimi që ju jepet të huajve në përgjithësi në të njëjtat rrethana, veçanërisht, për sa i përket aksesit në studime, njohjes së certifikatave, diplomave dhe gradave të lëshuara nga institucionet e huaja, përjashtimin nga tarifa dhe dhënien e bursave.

Parimet e Konventës së Gjenevës u riafirmuan në Dhjetor 2018 nga Kompakti Global për Refugjatët ku u kërkohet shteteve palë mbështetje më e drejtpërdrejtë financiare dhe përpjekje të veçanta për të minimizuar kohën që djemtë dhe vajzat refugjate qëndrojnë jashtë arsimit, idealisht një maksimum prej tre muaj pas mbërritjes. Fushat shtesë për mbështetje përfshijnë përpjekjet për të përmbushur specifikat nevojat arsimore të refugjatëve (përfshirë përmes "shkollave të sigurta" dhe metoda inovative si edukimi online) dhe kapërcimin e pengesave për regjistrimin dhe ndjekjen e mësimi, programet fleksibël të certifikuara të të mësuarit, veçanërisht për vajzat, si dhe personat me aftësi të kufizuara dhe trauma psikosociale. Mbështetja duhet të ofrohet gjithashtu për të lehtësuar njohjen dhe njësimin diplomave dhe kualifikimeve profesionale dhe akademike.

Direktiva 2003/9 e Bashkimit Evropian për përcaktimin e standardeve minimale për pritjen e azilkërkuesve kërkon që shtetet t'u sigurojnë akses në sistemin arsim edhe personave që kanë aplikuar për azil dhe nuk e kanë marrë akoma statusin e refugjatit. Aksesit në sistemin arsimor sipas direktivës së Bashkimit Evropian duhet t'u sigurohet të gjithë personave që nuk e kanë arritur moshën madhore. Qasja në sistemin arsimor nuk mund të shtyhet për më shumë se tre muaj nga data e paraqitjes së kërkesës për azil.⁸⁶

Sa i përket të drejtës kuadrit ligjor lidhur me të drejtën për arsim në Shqipëri, ligji nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", përcakton se kërkuesit fëmijë kanë të drejtë për ndjekjen e arsimit parauniversitar me të njëjtat kushte si edhe për fëmijët me shtetësi shqiptare. Ndjekja e arsimit parauniversitar nga kërkuesit fëmijë, bëhet brenda 3 (tre) muajve nga data kur është paraqitur kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare.⁸⁷

Sa më sipër legjislacioni shqiptar ka reflektuar parashikimet e konventës së Gjenevës dhe direktivës së pritjes së BE-së duke u siguruar akses në sistemin arsimor parauniversitar të huajve, të mitur që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, brenda 3 muajve nga paraqitja e kërkesës për azil.

⁸⁵ Convention And Protocol Relating To The Status Of Refugees <https://www.unhcr.org/media/convention-and-protocol-relating-status-refugees>

⁸⁶ Article 10 Council Directive 2003/9/EC of 27 January 2003 laying down minimum standards for the reception of asylum seekers <https://eur-lex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32003L0009&from=EN>

⁸⁷ Neni 59 i ligjit nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë"
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/02/01/10/48ad6f04-07d2-4d94-ad90-3df7051c6e84>

Arsimi parauniversitar në Shqipëri përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas “Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit”, përkatësisht:

- a) “Niveli me kodin 0”, arsimi parashkollor;
- b) “Niveli me kodin 1”, arsimi fillor;
- c) “Niveli me kodin 2”, arsimi i mesëm i ulët;
- ç) “Niveli me kodin 3”, arsimi i mesëm i lartë.⁸⁸

Në rastet kur personi ka fituar statusin e refugjatit ose statusin e mbrojtjes plotësuese ligji për azilin në Republikën e Shqipërisë e ka shtrirë të drejtën për arsim përveç arsimit parauniversitar edhe në arsimin e lartë. Edhe anëtarët e familjes së refugjatit, që kanë përfituar nga vendimi për bashkim familjar, kanë të njëjtat të drejta sikurse edhe kërkuesi për arsimim në institucionet arsimore.⁸⁹

Një ndër sfidat e regjistrimit në institucionet arsimore për fëmijët refugjatë lidhet me mungesën e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim. Duke mbajtur në konsideratë situatat nga të cilat fëmijët refugjatë vinë dhe interesin më të lartë të fëmijës në udhëzimin nr. 10, datë 17.5.2021 të ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë *“Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore parauniversitare publike të fëmijëve të personave në situatë migrimi/azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijë, viktime të trafikimit, në Republikën e Shqipërisë”* është parashikuar mënyra e regjistrimit për fëmijët për të cilët ka mungesë dokumentacioni ose nuk kanë dokumentacion për regjistrim.

Sipas udhëzimit të sipërcituar fëmijët e moshës 3–5 vjeç që nuk zotërojnë certifikatë lindjeje apo fëmijëve të huaj të pashoqëruar, regjistrohen në arsimin parashkollor, sipas deklaramit të prindërve/kujdestarit ligjor dhe dokumentacionit që fëmija zotëron nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

Nxënësit e moshës 6–21 vjeç, në situatë migrimi/azili, refugjatë, apo pa shtetësi, për të vazhduar mësimin në arsimin bazë ose arsimin e mesëm të lartë, paraqesin në ZVAP dëftesën/dëftesat origjinale të përkthyer dhe të noterizuara. ZVAP-ja bën ekuivalentimin e notave, siglon dëftesën e nxënësit dhe cakton institucionin arsimor parauniversitar publik ku do të vazhdojë mësimin nxënësi, sipas vendbanimit ku ai është vendosur:

- a) në klasën pasardhëse, kur vjen në fillim të vitit shkollor;
- b) në klasën përkatëse, kur vjen gjatë vitit shkollor.

Nxënësit që nuk provojnë me dokument zyrtar të shtetit nga vijnë, përfundimin apo vazhdimin e një klase, vlerësohen me testim, për shkallën e njohurive nga një komision ndërlëndor, i përbërë nga mësues dhe nga punonjësi i shërbimit psikosocial, që ngrihet në institucionin arsimor parauniversitar publik. Komisioni në bazë të vlerësimit cakton klasën ku nxënësit i

⁸⁸Pika 1, e nenit 2, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

⁸⁹Neni 63 dhe 74 i ligjit nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

përket të regjistrohet. Gjithashtu është parashikuar se institucioni arsimor parauniversitar publik siguron tekstet shkollore për fëmijët e personave në situatë emigrimi/azili, refugjatë apo fëmijëve të huaj të pashoqëruar.

Për fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit institucioni arsimor parauniversitar publik harton planin individual mësimor bazuar në vlerësimin e nevojave arsimore dhe të atyre psikosociale të këtyre fëmijëve.

Udhëzimi nr. 13, datë 30.6.2023 i ministrit të Arsimit dhe Sportit, i ndryshuar krijon lehtësira për njohjen e dëftesave dhe diplomave për refugjatët. Refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, të cilët paraqesin dokumentacion të pjesshëm, ose nuk mund të paraqesin dokumente për të vërtetuar kualifikimet e tyre dhe/ose periudhat e studimit, kanë të drejtën e njohjes dhe njësimit brenda një afati të arsyeshëm të kualifikimit të tyre dhe/ose periudhave të studimit, me qëllim për të vazhduar studimet e mëtejshme, ose për t'u punësuar.

Për njohjen dhe/ose njësimin e dëftesës së përfundimit të arsimit bazë, dëftesa klase, diplomave të përfundimit të arsimit parauniversitar, të fituara jashtë Republikës së Shqipërisë dhe/ose periudhave të studimit nga mbajtësit/titullarët e statusit të refugjatit, personave të zhvendosur dhe personave të ngjashëm me refugjatët, organet kompetente përcaktojnë procedurat e përshtatshme të vlerësimit, vlefshmërisë dhe kriterëve të tjera, që lejojnë njohjen e këtyre kualifikimeve dhe/ose periudhave të studimit, edhe në mungesë të verifikimit të vlefshmërisë së tyre, apo mungesës, apo paraqitjes së dokumentacionit të pjesshëm ligjor, në ato raste kur personat e interesuar provojnë pamundësinë për të verifikuar vlefshmërinë e këtyre diplomave/certifikatave, ose nuk mund të paraqesin dokumente që ta bëjnë këtë gjë.

Organet kompetente për njohjen dhe njësimin e dëftesës të arsimit bazë, dëftesa klase, diplomave të përfundimit të arsimit parauniversitar dhe/ose periudhave të studimit, duhet të përdorin çdo mjet të disponueshëm dhe çdo informacion të besueshëm për të verifikuar institucionet ku janë fituar kualifikimet, apo janë kryer periudhat e studimit dhe, gjithashtu, të përdorin, për aq sa është e mundur, çdo informacion apo praktikë të vlerësimeve të mëparshme për kualifikime të ngjashme për sa u përket vlefshmërisë, cilësisë, nivelit dhe rezultateve të të nxënit.

Për vitin 2023 rezulton se 5 azilkërkues fëmijë kanë ndjekur arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Lidhur me njohjen e kualifikimeve të refugjatëve, e personave të zhvendosur dhe e personave të ngjashëm me refugjatët bazuar në “Konventen për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Evropë” (Lisbonë, 1997) ratifikuar me ligjin nr. 8834, datë 22.11.2001 parashikohet se Secila Palë merr të gjitha masat e mundshme dhe të arsyeshme në kuadrin e sistemit të vet arsimor, konform dispozitave konstitucionale, ligjore dhe administrative, për të përpunuar procedurat e përshtatshme që lejojnë vlerësimin e drejtë dhe efikas, nëse refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët plotësojnë kushtet e nevojshme për hyrjen

në arsim të lartë, ndjekjen e programeve të arsimit të lartë plotësuese ose ushtrimin e një aktiviteti profesional dhe kjo do të ndodhë edhe kur kualifikimet e kryera në njërin nga Palët nuk mund të vërtetohen nga dokumente që mund ta bëjnë këtë gjë.

Në udhëzimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit për njohjen e diplomave të arsimit të lartë parashikohet një procedurë e veçantë për personat që kanë statusin e refugjatit, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët.⁹⁰

Refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, të cilët paraqesin dokumentacion të pjesshëm, ose nuk mund të paraqesin dokumente për të vërtetuar kualifikimet e tyre dhe/ose periudhat e studimit, kanë të drejtën e njohjes dhe njësimit pa pagesë dhe brenda një afati të arsyeshëm të kualifikimit të tyre dhe/ose periudhave të studimit me qëllim për të vazhduar studimet e mëtejshme, ose për tu punësuar.

Për njohjen dhe/ose njësimin e diplomave/certifikatave profesionale, diplomave që u përkasin niveleve 5–8, gradave shkencore, titujve akademikë dhe kualifikimet e tjera të fituara jashtë Republikës së Shqipërisë dhe/ose periudhave të studimit nga mbajtësit/titullarët e statusit të refugjatit, personave të zhvendosur dhe personave të ngjashëm me refugjatët, organet kompetente, përcaktojnë procedurat e përshtatshme të vlerësimit, vlefshmërisë dhe kriterëve të tjera, që lejojnë njohjen e këtyre kualifikimeve dhe/ose periudhave të studimit, edhe në mungesë të verifikimit të vlefshmërisë së tyre, apo mungesës, apo paraqitjes së dokumentacionit të pjesshëm ligjor, në ato raste kur personat e interesuar provojnë pamundësinë për të verifikuar vlefshmërinë e këtyre diplomave/certifikatave, ose nuk mund të paraqesin dokumente që ta bëjnë këtë gjë.

Kualifikimet e paraqitura duhet të vlerësohen nëpërmjet mbledhjes së informacionit nga burime të besueshme publike, rrjeti ENIC-NARIC, nga personi që aplikon për njohjen e kualifikimit dhe/ose periudhave të studimit dhe sipas rastit duhet të plotësohet me intervista me aplikantin, provimet dhe çdo metodë tjetër të përshtatshme vlerësimi.

Projekti i Pasaportës Evropiane të Kualifikimit për Refugjatët është një mjet i veçantë i zhvilluar nga Këshilli i Evropian, për të vlerësuar kualifikimet e refugjatëve të cilët kanë dokumentacion të pamjaftueshëm ose mungesë dokumentacioni me qëllim që të mbështesë studimet e tyre të mëtejshme, punësimin dhe integrimin e tyre.⁹¹

⁹⁰ Kreu IV i udhëzimit nr. 21, datë 15.10.2021 i ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në republikën e shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar", i ndryshuar.

⁹¹ Projekti realizohet nga Këshilli i Evropës, Ministria e Arsimit dhe Çështjeve Fetare të Greqisë, Ministria e Arsimit, Universitetet dhe Hulumtimi i Italisë, Konferenca e Rektorëve të Universiteteve Italiane dhe Rrjeti Evropian i Qendrave të Informacionit (ENICs/NARIC) të Armenisë, Kanada Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Norvegjia dhe Mbretëria e Bashkuar. Ministria e Arsimit dhe Kërkimit të Norvegjisë, Belgjika dhe UNHCR gjithashtu mbështesin projektin.

Pasaporta Evropiane e Kualifikimit për Refugjatë nuk është një dokument ligjor që zëvendëson skemat kombëtare të njohjes, por një deklaratë që synon të ndihmojë në lidhje me aplikimet për punësim/praktikë dhe studime. Vlerësimi bazohet në dokumentacionin e disponueshëm dhe intervistën e strukturuar me një vlerësues profesionist të kredencialeve.⁹²

Dokumenti shpjegon kualifikimet që një refugjat ka të ngjarë të ketë bazuar në provat e disponueshme. Edhe pse ky dokument nuk përbën një akt zyrtar njohjeje, ai përmbledh dhe paraqet informacionin e disponueshëm për nivelin arsimor të aplikantit, përvojën e punës dhe aftësitë gjuhësore. Metodologjia e vlerësimit konsiston në kombinimin e vlerësimit të dokumentacionit të disponueshëm, përvojës së fituar nga vlerësimet e mëparshme dhe përdorimin e një interviste të strukturuar. Kështu, dokumenti ofron informacion të besueshëm që mund të jetë i përshtatshëm në lidhje me aplikimet për punë, praktikë, kurse profesionale apo ndjekje të studimeve.

Pasaporta Evropiane e Kualifikimeve për Refugjatët u lëshohet refugjatëve që pretendojnë se kanë përfunduar ose kanë ndjekur pjesërisht studimet në nivelin e shkollës së mesme dhe vivelet më lart përfshirë edhe kualifikimet për të cilat kanë dokumentacion të pamjaftueshëm ose mungesë dokumentacioni. Qëllimi është që të ndihmojë aplikantët të vazhdojnë studimet e mëtejshme, të përmirësojnë njohuritë e tyre gjuhësore, të aplikojnë për njohjen formale të këtyre kualifikimeve ose të gjejnë punë.

6.1.3 Qasja në shërbimet shëndetësore

Në ligjin nr. 10/2021 “Për azilin” parashikohet se në Qendrat e Pritjes për Azil sigurohet kujdesi shëndetësor. Kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare kanë të drejtën për kujdes shëndetësor, i cili përfshin kujdesin e urgjencës shëndetësore, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe trajtimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve të rënda të shëndetit mendor. Kërkuesve që kanë qenë subjekte të përdhunimit, të ushtrimit të torturës, trajtimit çnjerëzor ose degradues apo formave të tjera të rënda të dhunës, si dhe kërkuesve që i përkasin kategorisë së veçantë u ofrohet trajtim i nevojshëm shëndetësor sipas nevojave specifike dhe pasojave të shkaktuara. Ndërsa personi me status refugjati ose personi me statusin e mbrojtjes plotësuese ka të drejtën për kujdes shëndetësor në kushte të njëjta me shtetasit shqiptarë.

Sipas Kompaktit Global për Refugjatët në përputhje me ligjet, politikat dhe planet kombëtare të kujdesit shëndetësor, shtetet duhet të përmirësojnë cilësinë e sistemeve kombëtare shëndetësore për të lehtësuar aksesin e refugjatëve dhe komuniteteve pritëse, duke përfshirë gratë dhe vajzat, fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë, personat e moshuar, ato me sëmundjet kronike, të mbijetuarit nga trafikimi, tortura, traumat ose dhuna, përfshirë dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore dhe personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu kërkohet të merren masa për të siguruar aksesin e barabartë në sasi të përshtatshme i barnave, furnizimeve mjekësore, vaksinave, diagnostifikimit dhe produkteve parandaluese.

⁹² <https://www.coe.int/en/ëeb/education/recognition-of-refugees-qualifications>

Gjatë inspektimit të kryer nga Avokati i Popullit në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve lidhur me shërbimin shëndetsor në këtë qendër është konstatuar si më poshtë:

“Organika e qendrës kishte mungesa në mjek me kohë të plotë, infermier dhe stomatolog, këto shërbime vijnë të mos ofrohen nga qendra, por në bashkëpunim me RMSA (Organizata Shërbimet Shqipëtare për Refugjatët) dhe UNHCR është mbuluar pozicioni i një infermieri për një periudhë 6-mujore. Me rikonstruksionin e mjediseve të qendrës, ishte parashikuar një dhomë e veçantë për mjekun me të gjitha pajisjet e duhura. Nuk kishte mungesa në furnizimin me medikamente. Institucioni nuk kishte një autoambulancë, por në raste emergjente përdorehin makinat e qendrës për transportimin e azilkërkuesve pranë qendrave spitalore. Gjithashtu ishin të hapura librezat shëndetësore për të gjithë azilkërkuesit e akomoduar në qendër, dhe skema e rimbursimit të ilaçeve ishte në funksion të plotë. Medikamentet mjekësore të rimbursueshme përfitoreshin me të njëjtën praktikë si shtetasit e tjerë të Republikës së Shqipërisë, në rastin konkret nga fondet e qendrës. Ndërsa medikamentet mjekësore të parimbursueshme bliheshin sipas procedurave të prokurimit publik.”⁹³

Në raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2023 citohet se Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), zhvilloi në datën 17.02.2023, një inspektim në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç. Në lidhje me shërbimin shëndetsor u konstatua se kishte problematika të mungesave në staf ndër të tjera mjeku, dhe stomatologu, mungesa të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në respektimin e të drejtave të personave të huaj të parregullt në Republikën e Shqipërisë. Qendra kishte vetëm një infermier i cili u përgjigjet nevojave dhe shërbimit mjekësor.

Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, zhvilloi në datën 06.09.2023, një inspektim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve ku u rekomandua të vlerësohej për shtimin e organikës me mjekë, infermierë, kujdestarë nate, të cilët janë të domosdoshëm për plotësimin e nevojave të qendrës. Gjithashtu edhe nga kontrolli i kryer në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, Linzë datë 8.09.2023 u konstatua se në Qendër pozicionin i Mjekut është vakant.

6.2 Punësimi i të Huajve: Rregullat dhe kërkesat për punësimin e të huajve.

Konventën Ndërkombëtare “Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.9703, datë 2.4.2007 parashikon detyrimin e shteteve palë që në përputhje me instrumentet ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut, marrin përsipër të respektojnë dhe garantojnë për të gjithë punëtorët migrantë dhe anëtarët e

⁹³Rekomandim Nr. Dok. 201900570/2, 2019

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëebbsite/media/Rekomandim%20p%C3%ABrmir%C3%ABsi%20i%20kushteve%20dhe%20i%20trajtimit%20t%C3%AB%20azilk%C3%ABrkuesve%20n%C3%AB%20Qendr%C3%ABn%20Komb%C3%ABtare%20Prit%C3%ABse%20p%C3%ABr%20Azilk%C3%ABrkuesit%200Babrru,%20Tiran%C3%AB.pdf>

familjeve të tyre, brenda territorit ose objekt i juridiksionit të tyre, të drejtat e parashikuara në konventë pa dallim gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, besimi, bindjesh politike ose të tjera, origjine kombëtare, etnike apo shoqërore, shtetësie, moshe, gjendjeje ekonomike, pasurie, gjendjeje civile, status lindjeje apo tjetër. Nuk është e lejueshme të ushtrohet asnjë formë presioni mbi punëtorët migrantë dhe anëtarët e familjeve të tyre, me qëllim që ata të heqin dorë apo të mos kërkojnë ndonjë nga të drejtat e caktuara. Nuk është e mundur që të devijohet me anë të kontratës nga të drejtat e njohura në Konventë. Shtetet Palë marrin masat e përshtatshme për të siguruar respektimin e këtyre parimeve.

Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit përmban detyrime të shumta, që burojnë nga dispozitat e neneve 48 dhe 49 të MSA, në fushën e qasjes në tregun e punës për shtetasit e BE-së në Republikën e Shqipërisë, lëvizjen e punëtorëve, kushtet e punësimit dhe trajnimit profesional. Aspekte të tjera të lëvizjes së lirë të punëtorëve kanë të bëjnë me promovimin e shkëmbimeve rinore dhe përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe për punësimin dhe formimin profesional ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit parashikon që, në përputhje me kushtet dhe modalitetet e zbatueshme, Shqipëria dhe Shtetet Anëtare të BE-së të sigurojnë që shtetasit e vendit partner të cilët janë të punësuar ligjërisht në territorin e tyre nuk janë objekt diskriminimi, për sa i përket kombësisë, kushteve të punës, shpërblimit apo pushimit nga puna.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 ofron një vlerësim të situatës së migracionit nga këndvështrimi i punësimit dhe aftësive. SKPA-ja, në masat që synojnë të realizojnë vizionin e saj për punësim dhe aftësi për të gjithë, gjatë të gjithë jetës, në mënyrë specifike për lëvizshmërinë e fuqisë punëtore, parashikon ndërhyrje që synojnë lidhjen me platformën evropiane të zyrave të punësimit (EURES), përmirësimin e kuadrit rregullator për rekrutimin e drejtë të punonjësve, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet zyrave publike dhe private të punësimit, identifikimin e aftësive të munguara në vend e rajon dhe plotësimin e tyre nëpërmjet promovimit të lëvizshmërisë në rajonin e Evropës Juglindore.

Qytetarët e BE-së kanë të drejtë të punojnë në Shqipëri pa leje pune. Kjo mundësohet nga dispozitat e ligjit për të Huajt dhe ndryshimeve pasuese, të cilat parashikojnë se të huajve nuk iu nevojitet leje pune apo certifikatë regjistrimi biznesi, nëse janë shtetas të një Shteti Anëtar të BE-së ose vendi Schengen dhe me qëndrim të ligjshëm në Shqipëri.

Ligji nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar parashikon se të drejtën e përfitimit të shërbimeve që ofrohen në strukturën rajonale/vendore e kanë të gjithë shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, të cilët hyjnë e qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, për qëllime punësimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt. Gjithashtu të drejtën e përfitimit të këtyre shërbimeve e kanë edhe të huajt, të cilët kanë përfituar statusin e refugjatit, si dhe azilkërkuesit në Republikën e Shqipërisë.

I huaji mund të punësohet në Republikën e Shqipërisë duke u pajisur me leje unike. Aplikimi për leje unike bëhet përmes sistemit elektronik të sigurt on-line Në momentin e përfundimit të

aplikimit të huajit i dërgohet një njoftim on-line për pranimin e aplikimit.⁹⁴

Autoriteti për marrjen e aplikimit dhe lëshimin e lejes unike është autoriteti i kufirit dhe migracionit. Për kategoritë e të huajve, të cilat në bazë të ligjit duhet të marrin miratimin e punësisimit, aplikimi shqyrtohet dhe aprovet on-line fillimisht nga AKPA-ja. Kategoritë që marrin miratim nga Agjencia Kombëtare e Punësisimit dhe Aftësive, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe në marrëveshje ndërshtetërore apo akte të tjera ligjore, janë punëmarrësit, punonjësit stinorë të transferuar brenda ndërmarrjes, punonjësit me kualifikim të lartë, vullnetarët, sportistët dhe shërbimet kontraktuale. Për kategorinë e të huajve të vetëpunësuar dhe investitorë, vlerësimi i plotësisimit të kushteve për pajisjen me leje unike bëhet nga komisioni vlerësues i ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë. Për kategoritë e të huajve, të cilët, në bazë të ligjit kanë nevojë të pajisen me vizë, viza miratohet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme pasi të jetë aprovuar miratimi i punësisimit nga AKPA-ja. Pas miratimit të punësisimit nga AKPA-ja dhe miratimit të vizës nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, autoriteti për kufirin dhe migracionin merr vendimin për lëshimin, ndryshimin ose ripërtëritjen e lejes unike, nëse aplikuesi përmbush kushtet e specifikuar në ligj. Për kategoritë që nuk kanë nevojë për miratim punësimi dhe miratim vize, aplikimi bëhet direkt te struktura përgjegjëse për çështjet e kufirit dhe migracionit. Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i lejes unike të qëndrimit, kur plotësohen kriteret e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, bëhen brenda një afati maksimal prej 12 javësh nga dita e aplikimit. Miratimi apo refuzimi i kërkesës i njoftohet on-line.

Dokumentacioni i nevojshëm për tu pajisur me leje unike si punëmarrës:

- Kontrata e punës si punëmarrës me një punëdhënës, në përputhje me formimin e tij profesional (kontrata e punës duhet të përmbajë të gjitha kërkesat e përcaktuara në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë për këtë dokument), ose kategorizimi si punëkërkues, në përputhje me marrëveshje reciproke ndërqeveritare.
- Dëshmi aftësimi (diploma/certifikata/referenca) ose vetëdeklarim për eksperiencën në punë) që vërteton aftësitë profesionale në përputhje me punën që do të kryejë sipas kontratës së punës.

Sipas raportit të INSTAT për vitin 2023, punësimi është arsyeja kryesore e lejeve të qëndrimit të të huajve në Shqipëri në 2023 me 48,3 %. Nga shtetet e Bashkimit Evropian, qytetarët italianë përbëjnë numrin më të madh të qytetarëve të BE-së në tregun shqiptar të punës dhe janë të punësuar kryesisht në fushën e mjekësisë, shërbimeve, marketingut, tregtisë, industrisë përpunuese, informacionit dhe telekomunikacionit. Qytetarët rumunë, të cilët janë grupi i dytë më i madh i qytetarëve të BE-së që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, janë të punësuar kryesisht në fushën e tregtisë dhe shërbimeve dhe *call centers*.

⁹⁴ Vendim nr. 858, datë 29.12.2021 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Rishikimi i kuadrit ligjor, rregullator dhe i mekanizmave për nxitjen e rekrutimit të drejtë (*fair recruitment*) nga vendet e huaja është një ndër objektivat e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, planit të veprimit për zbatimin e saj.⁹⁵

Gjithashtu në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, specifikisht parashikohen ndërhyrje për: përbushjen e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë migrante; rritjen e aksesit të grave migrante në shërbime dhe produkte financiare, informimin e grave migrante për të drejtat pronësore; reduktimin e barrierave që i mbajnë gratë, të rejtat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritjen e aksesit të grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet (migrantë dhe azilkërkues etj.), për punë të denjë edhe në sektorët e punësimit jotradicional (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë) dhe përmirësimin e shërbimeve të specializuara mbështetëse për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, trafikimit dhe shfrytëzimit seksual, nga të gjitha grupet e grave (përfshirë gratë migrante).

Të huajt i pajisur me leje të përhershme qëndrimi quhen banor afatgjatë dhe duhet të regjistrohen në zyrën përkatëse të gjendjes civile. I huaji që pajiset me letërnjoftim për të huajt, mund të punësohet, të vetëpunësohet ose të merret me veprimtari biznesi të drejtpërdrejtë, pa pasur nevojë të pajiset me leje punësimi. Banorët afatgjatë gëzojnë të drejtat ekonomike, shëndetësore dhe sociale, të njëjta me shtetasit shqiptarë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Një ndër objektivat e strategjisë kombëtare për migracionin është integrimi social-ekonomik i refugjatëve dhe azilkërkuesve. Sipas të dhënave mbi këtë tregues nuk rezulton asnjë azilkërkues i punësuar për vitin 2023.

⁹⁵ <https://arkiva.financa.gov.al/ep-content/uploads/2023/10/Strategjia-Kombetare-e-Punesimit-dhe-Aftesive-2023-2030-VKM-173.pdf>

VII. Konkluzione dhe Rekomandim

7.1 Konkluzione dhe gjetjet kryesore.

1. **Përputhshmëria me legjislacionin e BE-së:** Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme në përafrimin e kuadrit të saj ligjor për migracionin dhe azilin me legjislacionin e BE-së. Megjithatë, ky kuadër kërkon përditësime të vazhdueshme për të mbajtur ritmin me ndryshimet e fundit në BE, veçanërisht në fushat që lidhen me Kartën Blu dhe vizat. Në fushën e azilit, Shqipëria ka përfituar nga harmonizimi i legjislacionit me Direktivat e BE-së për azilin dhe migracionin, duke siguruar mbrojtje për refugjatët dhe migrantët sipas standardeve ndërkombëtare.
2. **Reduktimi i flukseve të parregullta:** Komisioni Evropian thekson se Shqipëria ka treguar përparim të dukshëm në menaxhimin e flukseve migratore të parregullta. Në vitin 2022, numri i migrantëve të parregullt që hynë në vend u reduktua me 34% krahasuar me vitin 2021. Kjo ulje reflekton përpjekjet e suksesshme të Shqipërisë për të kontrolluar kufijtë dhe për të menaxhuar migracionin e parregullt në bashkëpunim me organizata si Frontex. Kjo është një arritje pozitive, por duhet të theksohet se sfidat në këtë fushë mbeten ende.
3. **Qasja në procedurat e azilit:** Një nga sfidat kryesore është qasja e kufizuar në procedurat e azilit. Megjithëse numri i personave që kanë shprehur synimin për të kërkuar azil mbetet i lartë, shumë prej tyre nuk arrijnë të formalizojnë kërkesat për shkak të sfidave burokratike dhe qasjes së kufizuar në mbrojtje ndërkombëtare. Kjo tregon nevojën për përmirësimin e procedurave administrative dhe lehtësimin e qasjes për ata që kërkojnë mbrojtje.
4. **Mbrojtja e fëmijëve të pashoqëruar:** Fëmijët e pashoqëruar janë një grup veçanërisht vulnerabël dhe përballen me sfida të shumta në Shqipëri. Aktualisht, ekziston një mungesë e akomodimit të përshtatshëm dhe mbështetjes së veçantë për këta fëmijë. Kjo kategori kërkon kujdes të specializuar, duke përfshirë strehim të sigurt, mbështetje psikosociale dhe arsimim. Nevoja për një qasje më të strukturuar dhe të qëndrueshme për mbrojtjen e fëmijëve të pashoqëruar mbetet një nga çështjet kyçe.

7.2 Rekomandimet e Analizës:

1. **Përmirësimi i kuadrit ligjor:** Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet për përditësimin e legjislacionit të saj mbi migracionin dhe azilin, në përputhje me zhvillimet më të fundit në BE. Në veçanti, duhet të përafrohen dispozitat mbi bashkimin familjar dhe Kartën Blu të BE-së, për të siguruar që të huajt që punojnë dhe jetojnë në Shqipëri të

kenë të drejta të qarta dhe procedura transparente. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për migrantët ekonomikë dhe do të forcojë sistemin e menaxhimit të migracionit.

2. **Rritja e kapaciteteve për kthim:** Një tjetër rekomandim është përmirësimi i procedurave të kthimit të migrantëve të parregullt në vendet e origjinës së tyre. Kjo përfshin zhvillimin e mekanizmave të kthimit të sigurt dhe dinjitoz, duke respektuar të drejtat e migrantëve. Shqipëria duhet të forcojë kapacitetet për trajtimin e këtyre procedurave në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të sigurojë që proceset e kthimit të jenë të koordinuara dhe humane.
3. **Mbrojtja e fëmijëve të pashoqëruar:** Kjo kategori e vulnerabël kërkon masa të veçanta mbrojtjeje. Shqipëria duhet të rrisë kapacitetet për ofrimin e shërbimeve të përshtatshme për këta fëmijë, duke përfshirë akomodim të sigurt, mbështetje edukative dhe psikosociale. Përmirësimi i strukturave për menaxhimin e nevojave të tyre do të jetë jetik për të siguruar që fëmijët e pashoqëruar të mos mbeten pa mbrojtje të mjaftueshme.
4. **Bashkëpunimi ndërkombëtar:** Përmirësimi i situatës për migrantët dhe refugjatët kërkon një bashkëpunim të vazhdueshëm ndërkombëtar. Shqipëria duhet të vazhdojë të punojë ngushtë me BE-në, UNHCR, IOM dhe organizata të tjera ndërkombëtare për të siguruar që politika dhe praktikat e saj për menaxhimin e migracionit të përputhen me standardet ndërkombëtare. Ky bashkëpunim do të jetë kyç për adresimin e sfidave të flukseve migratore dhe përmirësimin e shërbimeve për migrantët dhe refugjatët në vend.
5. **Lidhur me punësimin:** Bazuar në standardet ndërkombëtare, Shqipëria ka një kuadër të plotë rregullator sa i përket punësimit të të huajve nëpërmjet lejeve unike të parashikuara në ligjin specifik. Rekomandohet që të krijohen lehtësira në procedurat e punësimit sa i përket marrjes së Kartës Blu, duke i siguruar të huajt edhe Kartën Blu edhe rezidencën në të njëjtën kohë dhe jo si procese të ndara.
6. **Lidhur me arsimin:** Ashtu si për punësimin dhe shërbimet të tjera të parashikuara për të huajt, ekzistojnë lehtësira të cilat garantojnë arsimimin e tyre, por rekomandohet të hapen programe të reja studimi në gjuhë të huaj dhe programe të përbashkëta e të dyfishta që lehtësojnë shkollimin e tyre.